



**RREGULLORJA E BRENDSHME
E FEDERATES SHQIPTARE TE
VOLEJBOLLIT**

2023 - 2024

TABELA E PERMBAJTJES

| | |
|--|-----------|
| KAPITULLI I | 5 |
| VEPRIMTARITË ZYRTARE KOMBËTARE DHE KUSHTET TEKNIKE | 5 |
| KAPITULLI II | 15 |
| ORGANIZIMI I VEPRIMTARIVE | 15 |
| KAPITULLI III | 21 |
| PJESËMARRJA DHE AKTIVIZIMI I SKUADRAVE DHE LOJTARËVE | 21 |
| <i>AKTIVITETET E BEACH – VOLLEY-it</i> | 32 |
| KAPITULLI IV | 34 |
| TRANSFERIMI I LOJTARËVE DHE TRAINEREVE | 34 |
| <i>TRANSFERIMI I LOJTARËVE DHE TRAINEREVE BRENDA VENDIT</i> | 34 |
| <i>HUAZIMI I LOJTARËVE BRENDA VENDIT</i> | 41 |
| <i>TRANSFERIMI I LOJTARËVE E TRAINERE TË HUAJ NË SHQIPËRI</i> | 42 |
| KAPITULLI V | 46 |
| TRANSFERIMI I LOJTARËVE SHQIPTARË JASHTË SHTETIT | 46 |
| KAPITULLI VI | 47 |
| KLASIFIKIMI | 47 |
| KAPITULLI VII | 49 |
| DËNIMET | 49 |
| KAPITULLI VIII | 55 |
| REKLAMIMI I NDESHJES | 55 |
| KAPITULLI IX | 56 |
| GJYTARËT, DELEGATI TEKNIK DHE KRYEGJYQTARI | 56 |
| KAPITULLI X | 63 |
| MENAXHIMI I LOJËS NGA GJYTARËT, KRYEGJYQTARI DHE DELEGATI TEKNIK | 63 |

| | |
|---|-----------|
| KAPITULLI XI | 69 |
| KATEGORIZIMI I TRAJNERËVE | 69 |
| KAPITULLI XII | 73 |
| DOKUMENTACIONI I SHOQATAVE SPORTIVE, TRAJNERË DHE GJYQTARËVE..... | 73 |
| <i>GJYQTARËT</i> | 75 |
| KAPITULLI XIII | 77 |
| RREGULLORE E SKUADRAVE KOMBËTARE | 77 |
| KAPITULLI XIV | 91 |
| RREGULLI UNIK I FSHV | 91 |

KAPITULLI I

VEPRIMTARITË ZYRTARE KOMBËTARE DHE KUSHTET TEKNIKE

NENI 1. Mënyra e organizimit të çdo veprimtarie kombëtare apo ndërkombëtare volejboli që do të zhvillohet në vendin tonë përcaktohet në bazë të: (i) Rregullores së Veprimtarive Zyrtare Kombëtare, e cila hartohet dhe miratohet nga Komiteti Ekzekutiv i FSHV-së; (ii) Rregullores Teknike të Lojës së Volejbollit, e miratuar nga Federata Botërore e Volejbollit (FIVB); (iii) Kodi i Etikës dhe Rregullorja e Disiplinës të miratuara nga Komiteti Ekzekutiv i FSHV-së; (iv) si dhenga të gjitha udhëzimet zyrtare që dërgohen nga sekretariati i FSHV-së.

- 1.1 Veprimtaritë Zyrtare Kombëtare që organizohen nga FSHV ose nga subjektet të deleguara prej saj, janë si më poshtë vijon:
- a. Kampionati kombëtar: Superliga dhe liga për të rritur meshkuj dhe femra, të rinjë (U-21), të reja (U-20), para të rinjë (U-19), para të reja (U-18), p/para të rinjë (U-17) dhe p/para të reja (U-16), dhe fëmijë meshkuj (U-15) dhe femra (U-14).
 - b. Kupa e Shqipërisë: të rritur meshkuj dhe femra, të rinjë (U-21), të reja (U-20), para të rinjë (U-19), para të reja (U-18), p/para të rinjë (U-17) dhe p/para të reja (U-16), dhe fëmijë meshkuj (U-15) dhe femra (U-14).
 - c. Kupa e FSHV: të rritur meshkuj dhe femra
 - d. Kupa Rinia: të rinjë (U-21), të reja (U-20), para të rinjë (U-19), para të reja (U-18), p/para të rinjë (U-17) dhe p/para të reja (U-16), dhe fëmijë meshkuj (U-15) dhe femra (U-14).

- e. Super Kupa: të rritur meshkuj dhe femra, të rinjë (U-21), të reja (U-20), para të rinjë (U-19), para të reja (U-18), p/para të rinjë (U-17) dhe p/para të reja (U-16), dhe fëmijë meshkuj (U-15) dhe femra (U-14).
- f. Aktivitetet e Beach – Volej: meshkuj, femra, të rinjë, të reja e fëmijë.
- g. Liga Gjergj Kastrioti dhe Kupa e Pavarësisë: të rritur meshkuj dhe femra
- h. Liga Amatore
- i. Festivale fëmijësh e turne të ndryshëm (volejboli dhe beach-volej).

1.1.1 Vendi, data, ora dhe mënyra e zhvillimit të çdo veprimtarie përcaktohet në kalendarin sportiv kombëtar, në përputhje me strukturën organizative miratuar nga Komiteti Ekzekutiv i FSHV e publikuar në Rregulloren e Veprimtarive Kombëtare Zyrtare.

1.2 Kalendar kombëtar është i detyrueshëm të zbatohet, nga të gjitha skuadrat e volejbollit. Ai mund të ndryshojë vetëm në rastet e mëposhtëme:

1.2.1 Evenimente të jashtëzakonëshme (epidemi, tërmet, përmbytje, gjendje të jashtëzakonëshme, mungesë e rendit publik, mungesë e sigurisë publike) të konfirmuara nga institucionet përkatëse qëndrore shtetërore, si dhe në rastet e mungesës së kushteve normale të infrastrukturës së sallave sportive të parashikuara në këtë rregullore. Për këto raste do të veprohet si më poshtë:

1.2.1.1 Ndeshjet e kampionateve kombëtare, (përfshirë fazën play-off dhe play-out), kupës së Shqipërisë, (ndeshje eliminatore dhe ato finale), kupa e FSHV-se, kupa e Rinisë, aktivitete ndërkombëtare si liga “Gjergj Kastrioti”, kupa e Pavarësisë etj, mund të ndërpriten, sipas urdhërit të autoriteteve shtetërore, për një periudhë të pacaktuar, dhe të rifillojnë po në bazë të urdhërit

të miratuar po nga autoritetet, në bazë të vendimit që do të marrë sipas rastit KE dhe asambleja e FSHV-së.

- 1.2.1.2 Në të gjitha ndeshjet që do të zhvillohen sipas kalendareve shoqatat sportive duhet të marrin të gjitha masat që të plotësohen protokollat zyrtare për zhvillimin normal të ndeshjeve në kushtet e reja pas gjendjes së jashtëzakonëshme.
- 1.2.1.3 Mosplotësimi i kushteve nga shoqatat sportive përkatëse në kalendar sipas protokolleve zyrtare të lëshuar nga organet shtetërore, ndeshja nuk do të zhvillohet dhe do të humbet nga skuadra pritese sipas rastit me rezultatin 0-3 dhe pikët (0-75) ose 0-2 dhe pikët (0-50).
- 1.2.1.4 Kushtet për zhvillimin normal të ndeshjeve, pas gjendjes së jashtëzakonëshme duhet të kontrollohen nga supervizori, kryegjyqtari dhe në mungesë të tyre do të bëhet nga arbitri i parë i ndeshjes, të cilët, në këto raste të veçanta, duhet të paraqiten minimalisht 1 (një) orë para orarit zyrtar të fillimit të ndeshjes.
- 1.2.1.5 Te gjitha kontratat ose akt-marrëveshjet që kanë lidhur lojtarët meshkuj e femra 15-18 vjeç dhe 18-33 vjeç e lart, me shoqatat sportive, do të konsiderohen të vlefshme për shkak të gjendjes së jashtëzakonëshme, për aq kohë sa shtyhet zhvillimi i aktiviteteve sipas kalendarëve për të gjitha kategoritë
- 1.2.1.6 Në qoftë se kampionati kombëtar dhe aktivitetet e tjera, ndërpriten për arsye të gjendjes së jashtëzakonëshme të miratuar nga autoritetet kompetente shtetërore dhe nuk mund të vazhdojnë më, në bazë të vendimit të Asamblesë së FSHV-së dt.12.06.2020, nuk do të shpallen ekipe kampione për të gjitha kategoritë e moshave, por ekipet të cilat janë në vendet e para nëkampionatet e tyre respektive do të shpallen fitues.

- 1.2.1.7 Për arsye të gjendjes së jashtëzakonëshme, nuk do të shpërndahen kupa e medalje për fituesit, si dhe nuk do të jepet shpërblim për ekipet fituese, si për meshkuj, ashtu edhe përfemra.
- 1.2.1.8 Në rast se gjendja e jashtëzakonëshme vazhdon, fillimi dhe rifillimi i kampionateve kombëtare për meshkuj e femra, të rinjë dhe të reja, para të rinjë dhe para të reja, kampionatet e moshave, liga amatore e volejbollit etj, ato do të vazhdojnë të luhen kur të lejohen nga organet shtetërore kompetente.
- 1.2.2 Kur skuadra zhvillon ndeshje zyrtare ndërkombëtare brenda dhe jashtë vendit, atëherë ndeshja e rradhës sipas kalendarit do të zhvillohet, 2-3 ditë para dhe jo më vonë se 48 orë, pas kthimit të skuadrës në vend.
- 1.2.3 Për aktivitetet miqësore ndërkombëtare shoqata sportive duhet të njoftojë jo më vonë se dy javë përpara në FSHV, për datën e zhvillimit të aktivitetit miqësor ndërkombëtar, i cili mund të konfirmohet nga FSHV vetëm në qoftë se nuk ndikon në zhvillimin normal të ndeshjeve sipas kalendareve sportive.
- 1.3 Shoqatat sportive nuk kanë të drejtë të ndryshojnë sallën, datën dhe orarin e ndeshjeve të kampionatit kombëtar, pa marrë më parë miratimin nga Sekretariati i FSHV-së. Ndryshimi do të bëhet me formularin e dyfishtë që do të nënshkruhet nga të dy ekipet dhe do të dërgohet në FSHV jo më vonë se 72 orë para zhvillimit të ndeshjes. Pra, edhe pas dërgimit të formularit të dyfishtë është sekretariati i FSHV-së, ai që vendos për ndryshimin e orarit, datës apo edhe vendit të zhvillimit të ndeshjes.
- 1.4 Vendit që i është deleguar e drejta për të qenë organizator i veprimtarive me sistem grumbullimi mund të ndryshojë para

fillimit të aktivitetit, vetëm orarin e ndeshjeve me miratimin e sekretariatit të FSHV-së.

- 1.5 Të gjitha veprimtaritë kombëtare zyrtare të të gjitha niveleve, të rritur, të rritura, të rinjë (U-21), të reja (U-20), para të rinjë (U-19), para të reja (U-18), si kampionati kombëtar, kupa e Shqipërisë, kupa e FSHV-së, kupa e Rinisë, etj., do të zhvillohet detyrimisht në pallate sporti dhe palestra sportive, të miratuara nga Komisioni Tekniko–Arbital i FSHV-së, para fillimit të çdo sezoni sportiv.
 - 1.5.1 Në infrastrukturën e pallateve të sportit apo palestrave sportive ku do të zhvillohen ndeshjet e veprimtarive zyrtare kombëtare apo ndërkombëtare, shoqata pritëse në kalendar duhet të ketë detyrimisht për çdo ndeshje paisjet e mëposhtëme:
 - a. Flamurin kombëtar dhe banerin me logon e FSHV-së.
 - b. Flamujt e klubeve apo shoqatave sportive.
 - c. Qendrën e zërit, shërbimin e internetit, kompjuter ose laptop, printer funksional
 - d. Tavolinën e sekretarisë, flamujt për gjyqtarët anësor, rrjetë dhe antena rezervë
 - e. Protokollet e ndeshjeve, topat e lojës, fletë vendosje për skuadrat.
 - f. Tabelën e pikëve manuale dhe elektronike, fshirëset e parketit, sinjalizuesin për pushimet dhe ndërrimet e lojtarëve,
 - g. Mbledhësit e topave (5 persona), fshirësit e parketit (2 persona) mbajtësin e pikëve (1 person), dhe mbajtësin e statistikave dhe protokollit elektronik ose manual (1 person).
 - 1.5.2 Pallatet e sportit dhe palestrat sportive ekzistuese sipas qyteteve respektive ku mund të zhvillohen veprimtaritë zyrtare të volejbollit, klasifikohen si më poshtë vijon:

- a. Pallate sporti: P.S. A. Rusi (salla qëndrore) Tiranë, Durrës, Elbasan, Korçë, Vlorë, Gjirokastrë, Shkodër, Përmet, kompleksi Fani Pogradec, Peshkopi, Tropojë, salla Feti Borova, Tirana Olimpik, Kompleksi Goga, Shijak, Farke Tiranë.
 - b. Palestra sportive: Farije Hoti Tiranë, Krutje, Rrëshen, Gramsh, Lushnje, Fier, Divjakë, Vlorë, Pogradec, palestra shkolla Vasil Shanto, Tiranë, P.S. A. Rusi, Tiranë (Salla nr.2), F. Krujë, Shijak, M.S. Durrës, palestra shkolla mesme Librazhd.
- 1.5.3 KE pasi merr në shqyrtim të gjithë formularët e plotësuar dhe verifikuar nga Komisioni Tekniko–Arbitral, ka të drejtë të miratojë rast pas rasti palestrat sportive, të cilat janë në përputhje me rregulloren teknike të lojës për ndeshjet në nivelin e ekipeve të rritur/ rritura, të rinjë (U-21), të reja (U-20) para të rinj, (U- 19), para të reja (U-18), p/para rinj (U-17), p/para të reja (U-16) dhe fëmijë meshkuj (U-15) dhe femra (U-14).
- 1.6 Në të gjitha veprimtaritë zyrtare kombëtare të të gjitha niveleve, shoqatat pritëse sipas kalendarit duhet të ketë në dispozicion mjekun e ndeshjes, i cili duhet të jetë i pranishëm gjatë gjithë ndeshjes, në gadishmëri për t'i dhënë ndihmën e parë të dyja skuadrave. Në rast të mungesës të mjekut të ndeshjes, ekipi i shoqatës që është pritëse humbet ndeshjen në tavolinë, sipas rastit 0-3 (0-75) ose 0-2 (0-50)
- 1.7 Të gjitha pallatet e sportit dhe palestrat sportive duhet të disponojnë të gjitha paisjet e nevojshme për zhvillimin e ndeshjeve. Të kenë dhoma zhveshjeje dhe ambiente normale hidrosanitare, për të dyja skuadrat, gjyqtarët dhe zyrtarët e ndeshjes.

- 1.8 Në të gjitha veprimtaritë zyrtare kombëtare të të gjitha niveleve, shoqatat pritëse sipas kalendarit përfshirë edhe shoqatat respektive të kryeqytetit janë përgjegjëse për:
- a. Sigurimin e bazës materiale për ndeshje në përputhje me standartet e parashikuara në rregulloren teknike të FIVB dhe rregulloren e brendëshme të FSHV-së.
 - b. Sigurimin e energjisë elektrike për sallën ku do të zhvillohen ndeshjet.
 - c. Sigurimin e pranisë të forcave të rendit publik, (polici private, polici bashkiake, polici të shtetit gjatë gjithë kohës së zhvillimit të aktivitetit. Në rast të mungesës së organeve të rendit publik, ekipi i shoqatës që është pritëse në kalendar, humbet ndeshjen në tavolinë 0-3 dhe pikët (0- 75).
 - d. Sigurimin e një kompjuteri dhe printer funksional si dhe shërbimin e internetit, për mbajtjen e statistikave dhe protokollit elektronik si dhe sekretarit për mbajtjen e protokollit manual. Në rast se infrastruktura nuk është gati për të realizuar mbajtjen e statistikave dhe protokollin e ndeshjes (elektronik dhe atë manual) do të merren këto masa si më poshtë vijon:
 - Shoqata sportive që nuk mban statistikën, protokollin elektronik dhe manual siç duhet për arsye të mosplotësimit të kushteve (infrastrukturës, paisjeve, mungese të statistikienit dhe sekretarit/es) dënohet sipas akteve nënligjore për herën e I-rë të mosmbajtjes së statistikave dhe protokollit elektronik e manual me 5.000 lekë.
 - Për mosmbajtjen e statistikave, protokollit elektronik dhe manual për herën e II-të dënohet sipas akteve nënligjore me 10.000 lekë.
 - Ndaj personave të liçensuar nga FSHV, në rastet kur ato nuk përmbushin siç duhet procedurën e mbajtjes së protokollit elektronik dhe manual dënohen sipas akteve nënligjore; (i) 2.000 lekë gjobë për mosmbajtjen e protokollit për herën e I-rë; (ii) 5.000 lekë gjobë dhe

paralajmërim për mosmbajtjen e protokollit për herën e II-të; (iii) revokim i licensës nga ana e FSHV-së për mosmbajtjen e protokollit për herën e III-të.

- e. Të sigurojë menaxhimin e drejtë të tifozave të skuadrës së tij në respektim të rregullores karshi gjyqtarëve dhezyrtarëve të ndeshjes.
- f. Në pallatet e sportit dhe palestrat sportive ku zhvillohen ndeshjet ndalohet kategorikisht ndezja e flakadaneve dhe e mjeteve të tjera që shkaktojnë zjarr dhe ndaj organizatorëve të ndeshjeve dhe shoqatave / klubeve sportive do të merren masat e mëposhtëme:
 - Për rastin e parë të ndezjes së flakadanëve në sallat ku zhvillohen ndeshjet, shoqata organizatore e aktivitetit të gjobitet sipas akteve nënligjore me 100.000 lekë
 - Në rast përsëritje të ndezjes së flakadanëve në sallat ku zhvillohen ndeshjet shoqata ose klubi organizator i aktivitetit të gjobitet sipas akteve nën ligjore me 500.000 lekë.
 - Në rast se vazhdon të kemi ndezje të flakadaneve në sallat ku zhvillohet ndeshja më shumë se dy herë ndaj shoqatës ose klubit organizator do të gjobitet me 500.000 leke, dhe do t'i zbriten dhe 6 (gjashte) pikë në klasifikim e kampionatit kombëtar ekipit i cili po luan ndeshjen.

1.9 Në të gjitha rastet kur kushtet e sallës, ndriçimi dhe kushtet atmosferike bëjnë të pa mundur teknikisht zhvillimin e ndeshjes, atëhere do të procedohet sipas Rregullores Teknike.

1.9.1 Kur ndeshja e kalon kufirin e ndërprerjes prej 4 orësh, ajo do të përsëritet, ditën e nesërme, duke filluar nga fillimi. Ora e fillimit të ndeshjes do të përcaktohet vetëm nga gjyqtarët e ndeshjes, pas konsultimit me kapitenët e të dyja skuadrave dhe delegatin teknik ose kryegjyqtarin (në rastet kur ai është i caktuar për ndeshjet).

- 1.9.2 Ndashja që nuk përfundon sipas pikes 1.9.1 do të zhvillohet para ndeshjes pasardhëse në një vend dhe datë, që do të caktohet nga sekretariati i FSHV-së.
- 1.9.3 Të gjitha ekipet për të rritur dhe të rritura, të rinjë (U-21) dhe të reja (U-20), para të rinj (U-19) e para të reja (U-18) që janë pritëse në kalendarin e ndeshjeve të fazave të rregullta të kampionatit kombëtar, fazave play-off dhe play-out, apo ndeshjet e kupes së Shqipërisë, kupës së FSHV-së etj., të përcaktuara në “Rregulloren e Veprimtarive Zyrtare Kombëtare”, e miratuar nga KE, janë përgjegjëse për organizimin e ndeshjeve (përfshirë gjithë detyrimet financiare dhe bazën materiale të nevojshme), si dhe sallën e zhvillimit të ndeshjeve në përputhje me nenin 1.5.1 dhe 1.5.2 të kësaj rregulloreje.
- 1.9.4 Të gjitha skuadrat e kryeqytetit do t’i zhvillojnë ndeshjet e tyre në fazën FINALE të Play-off-it në sallat e miratuara nga KE dhe që plotësojnë standartet për transmetim televiziv.
- 1.9.4.1 Ndashjet finale të kupës së Shqipërisë për meshkuj dhe femra do të zhvillohen detyrimisht në pallate sporti të miratuara nga FSHV në përputhje me nenin 1.5.2 të kësaj rregulloreje dhe që plotësojnë standartet për transmetim televiziv. KE mund të delegojë zhvillimin e ndeshjeve finale të kupës të Shqipërisë, pas kërkesës me shkrim që një klub apo shoqatë sportive mund të kërkojë, duke garantuar shpenzimet e aktivitetit dhe garancinë zhvillimit të tyre në pallate sporti, sipas nenit 1.5.1 dhe 1.5.2.
- 1.9.5 Në të gjitha veprimtaritë zyrtare kombëtare nuk lejohet që një shoqatë sportive të ndryshojë topin apo topat e lojës, që janë miratuar më parë nga sekretariati i FSHV-së. Topat e lojës për superligen meshkuj e femra, femra kategoria parë, të rinjë e të reja (U21 dhe U-20) janë: Mikasa V 200 W dhe për para të rinjë

e para të reja dhe p/para të rinjë e p/para të reja U-17 e U-16 janë Mikasa MVA 200.

- 1.9.5.1 Të gjitha shoqatat që janë anëtarë të FSHV-së, kur duan të organizojnë aktivitete miqësore volejbolli apo beach-volley me mbi tre skuadra (në beach-volley një çift është një skuadër), duhet detyrimisht të marrin lejen e miratimit për zhvillimin e aktivitetit që lëshohet nga sekretariati i FSHV-së.
- 1.9.5.2 Të gjitha shoqatat që janë anëtare të FSHV-së, kur duan të organizojnë ndeshje miqësore ndërkombëtare volejbolli apo beach-volley në vendin tonë, janë të detyruara të marrin, lejen e miratimit për zhvillimin e aktivitetit, që lëshohet nga sekretariati i FSHV-së.
- 1.9.5.3 Asnjë subjekt publik apo privat, i cili nuk është anëtar i FSHV-së, nuk ka të drejtë të organizojë dhe të marrë pjesë, në veprimtari e aktivitete kombëtare volejbolli dhe bech-volley, pa miratimin dhe lejen e lëshuar nga sekretariati i FSHV-së.
- 1.9.6 Në rast të mos respektimit të neneve 1.9.5.1; 1.9.5.2; 1.9.5.3; të gjitha shoqatat apo subjektet publike apo private që do të organizojnë veprimtari pa marrë më parë lejen nga sekretariati i FSHV, do të gjobiten me shumën nga 50.000 – 200.000 lekë.

KAPITULLI II

ORGANIZIMI I VEPRIMTARIVE

NENI 2. Shoqata pritëse në kalendarin e aktiviteteve ose shoqata së cilës i është deleguar organizimi i një aktiviteti duhet të garantojë marrjen e të gjitha masave të domosdoshme për zhvillimin normal të ndeshjeve. Ata do të përgjigjen për pritjen, përcjelljen e skuadrave, gjyqtarëve, delegatit teknik (supervizorit) si dhe marrjen e të gjitha masave organizative dhe të sigurisë për zhvillimin normal të aktivitetit.

- 2.1 Për strehimin e skuadrës në bazë të njoftimit zyrtar të dërguar nga skuadra mike përgjigjet shoqata sportive pritëse. Në rast reklamimi detyrimisht ai duhet të shoqërohet me gjithë dokumentacionin e korrespondencën zyrtare përkatëse.
- 2.2 Sekretariati i FSHV nuk përgjigjet për sigurimin e automjeteve të udhëtimit për skuadrat gjyqtarët e delegatrin teknik (supervizorin).
- 2.3 Vonesat në oraret e zhvillimit të ndeshjeve të caktuara si dhe vonesat e korespondencës postare nuk merren parasysh.
- 2.4 Në fillim dhe mbarim të çdo veprimtarie do të zhvillohet ceremonia e hapjes dhe e mbylljes. Skuadrat janë të detyruara të marrin pjesë me të gjithë lojtarët dhe trainerët, e tyre të regjistruar në protokollin e ndeshjes. Cermonia e dorëzimit të titullit “kampion” për të gjitha nivelet do të shoqërohet me medaljet përkatëse për ekipet finaliste dhe kupë për vendin e I-rësi dhe shperblim financiar që miratohet nga KE. Për të gjitha kupat e tjera që organizohen nga FSHV, ceremonia do të konsistojë në dhënjen e kupës për vendin e I-rë.

- 2.4.1 Për lojtarët, trainerët dhe ekipet, të cilat nuk paraqiten në cermonitë e hapjes dhe mbylljes së aktivitetit do të merren këto masa: Lojtarët, trainerët do të gjobiten sipas akteve nënligjore nga 10.000 – 20.000 lekë dhe do të jenë objekt i komisionit të disiplinës. Ndërsa për ekipet që nuk paraqiten në këto cermoni do të gjobiten sipas akteve nënligjore nga 80.000 – 100.000 lekë.
- 2.5 Për organizimin e cermonisë së hapjes ose të mbylljes të një veprimtarie përgjigjet shoqata sportive që i është deleguar drejta e veprimtarisë nga KE ose që është pritëse në kalendar.
- 2.5.1 FSHV do të mbulojë shpenzimet për udhëtimin, dietat e gjyqtarëve të ndeshjes dhe delegatit teknik (supervizorin)dhe/ose kryegjyqtarin, sipas tarifave të përcaktuara nga KE.
- 2.5.2 40 (dyzet) minuta para fillimit të ndeshjes, delegati teknik (supervizori), kryegjyqtari dhe gjyqtarët e ndeshjes duhet të kontrollojnë dokumentacionin e skuadrave (listat e federimit dhe liçensat). Ata duhet të kontrollojnë rregullsinë e dokumenteve (firmat dhe vulat përkatëse), pastaj të japin konfirmimin për regjistrimin e tyre në protokollin e ndeshjes. Personat që nuk janë të regjistruar (federuar) dhe nuk kanë license, nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në ndeshje dhe nuk lejohen të futen në teritorin e zhvillimit të lojës, si dhe në të gjithë hapësirën ku zhvillohet ndeshja.
- 2.6 Liçensat e skuadrave duhet të qëndrojnë në tavolinën esekretarisë nga fillimi deri në përfundim të ndeshjes.
- 2.6.1 Në rast se ndonjë ekipi, lojtari, treneri/e, mjeku etj, i humbin liçensat, atëherë drejtuesit e shoqatës sportive duhet të njoftojnë menjëherë në FSHV, për zëvendësimin e saj/tyre (sipas taksës përkatëse).

- 2.6.2 Në rast të mos zëvendësimit të licensës/liçensave në kohën e duhur, trajneri/ja duhet të paraqesë në ndeshje listen e federimit të shoqëruar me dokumentat e identifikimit, pasaportë ose kartë identiteti. Në këtë rast, trainer/ja i/e skuadrës lëshon para ndeshjes një deklaratë, në praninë të gjyqtarëve të ndeshjes, dukemarrë përgjegjësitë e sanksioneve që mund të rrjedhin nga verifikimi i plotë i dokumantacionit nga sekretariati i FSHV-së.
- 2.6.3 Gjyqtarët para ndeshjes duhet të kontrollojnë dokumentet e këtyre personave:
- Lojtarë deri 12 plus dy libero (listë federimi + licencë).
 - Trajnerë: 1 trajner/e dhe 1 ose 2 zv.trajnerë (listë federimi + license)
 - Mjek/e dhe masazhator/e (fizoterapist/e) me liçencë.
- Të gjitha liçencat duhet të jenë me fotografinë përkatëse të çdo personi dhe të miratuara nga sekretariati i FSHV-së, për çdo sezon sportiv. Fotografitë duhet të jenë në format dixhital dhe të dërgohen me e-mail pranë FSHV-së. Ato duhet të shoqërohen me emër, mbiemër, datëlindja, gjinia, kombësia, funksioni dhe ekipi ku bën pjesë secili person. Gjithashtu çdo liçencë do të ketë edhe barcode-in e saj.
- 2.7 Në tavolinën e sekretarisë duhet të qëndrojnë vetëm sekretari i ndeshjes (për protokollin elektronik ose manual), shënuesi i pikëve, delegati teknik (supervizori) ose kryegjyqtari. Asnjë person tjetër nuk ka të drejtë të ulet në tavolinën e sekretarisë.
- 2.8 Në të gjitha ndeshjet zyrtare apo miqësore, shoqata pritëse në kalendar është përgjegjëse për sjelljen e publikut dhe tifozëve të saj para, gjatë dhe pas ndeshjes. Në të gjitha rastet kur spektatorët do të bëhen pengesë për zhvillimin normal të ndeshjeve, atëhere do të veprohet sipas neneve të mëposhtëm
- 2.8.1 dhe 2.8.2.

- 2.8.1 Në pallatet e sportit apo sallat sportive ku ndodhin thyerje të Rregullores së Brendëshme dhe Kodit të Etikës, të cilat pengojnë zhvillimin normal të ndeshjes, Komisioni i Disiplinës i FSHV-së vendos për zhvillimin e ndeshjeve në këto pallate apo salla sportive, pa praninë e publikut. Lejohen të aktivizohen në këtë rast: skuadrat, trajnerët, përgjegjësit e shoqatave mjek apo masazhator, gjyqtarët e delegati teknik (supervizori) si dhe organet e ruajtjes së rendit publik (polici private, policibashkiake apo policia e shtetit)
- 2.8.2 Në rast se ç’rregullimet do të vazhdojnë dhe do të ndikojnë direkt në rezultatin përfundimtar të ndeshjes, atëherë Komisioni i Disiplinës i FSHV-së vendos për pezullimin e ndeshjeve në këtë pallat apo sallë sportive, për një periudhë të caktuar ose përgjithmonë dhe klubi/shoqata sportive vendase (pritëse në kalendar) gjobitet sipas akteve nënligjore, me 100.000 lekë.
- 2.9 Nuk lejohet që gjatë një ndeshje zyrtare skuadrat të ndryshojnë uniformën. Vetëm në rast kur një lojtar apo më shumë lojtarë kërkojnë ndërrimin e saj për arsye të ndotjes apo dëmtimit, atëhere vetëm kapiteni i lojës ka të drejtë të kërkojë autorizimin e gjyqtarëve për ndërrimin e uniformës, e cila duhet të jetë identike dhe me të njëjtin numër me të parën. Ndërrimi i uniformës mund të bëhet në pushimet ndërmjet seteve apo kur lojtari është ndërruar me një lojtar tjetër. Zëvendësimi i uniformës bëhet vetëm në stolin e skuadrës në dhomën e zhveshjes.
- 2.9.1 Në rastet kur një lojtar ose disa lojtarë veshin ndonjë bluzë tjetër nën fanellën e lojës apo nën mbathjet e shkurtëra, të dallueshme nga uniforma sportive e skuadrës, këto mund të lejohen vetëm atëhere kur ato kanë të njetën ngjyrë.
- 2.10 Vetëm kapiteni i lojës ka të drejtë të komunikojë me gjyqtarët gjatë ndeshjes. Nuk lejohet që personat e tjerë të cilët janë në

stolin e skuadrës të kominikojnë me gjyqtarët e lojës, gjatë ndeshjes.

- 2.10.1 Në rastet kur skuadrat paraqitet pa trajner/e dhe mungon dhe zv/trajneri/ja, asnjë person tjetër nuk ka të drejtë të drejtojë skuadrën nga stoli. Të drejtën për të kërkuar ndërprerje të rregullta të lojës e ka vetëm kapiteni i lojës.
- 2.10.2 Në rast se trajnerët, zv/trajnerët e ekipeve, të cilët janë të liçensuar nga ana e FSHV, në listat përkatëse të federimit, nuk paraqiten pa arsye për të drejtuar ekipet e tyre në 3 ndeshje, atyre u hiqet liçensa dhe gjobiten sipas akteve nënligjore me 10.000-20.000 lekë dhe do të jenë objekt i komisionit të disiplinës.
- 2.10.3 Zv/trajneri/ja mund të drejtojë skuadrën gjatë një ndeshjeje vetëm me kërkesën e kapitenit të skuadrës karshi gjyqtarit të parë në rastet kur:
- Trajneri/ja i parë largohet vullnetarisht nga ndeshja.
 - Trajneri/ja i parë largohet për arsye të dënimit nga gjyqtarët.
 - Trajneri/ja i parë nuk paraqitet në ndeshje.
- 2.11 Për fitimin e veprimtarive kombëtare FSHV vlerëson skuadrat, lojtarët, trajnerët me stimujt morale e material si më poshtë:
- Kupa
 - Medalje
 - Diploma
 - Vleftë në lekë sipas vendimeve të Komitetit Ekzekutiv.
- 2.12 FSHV organizon në bashkëpunim me Komisionin Tekniko-Arbitral dhe specialist volejbolli strukturën prej 5 personash për shpalljen e lojtarëve më të dalluar në veprimtaritë zyrtare bazuar në statistikat e ndeshjeve dhe sjelljet e lojtarëve gjatë ndeshjeve, si dhe përcakton shpërblimin e tyre me stimuj morale e materialë:
- Lojtarin/en më të mirë për meshkuj e femra.

- Sulmuesin /en më të mirë për meshkuj e femra.
- Organizatorin/en më të mirë për meshkuj e femra.
- Liberon më të mirë për meshkuj e femra.

- 2.13 Në të gjitha veprimtaritë zyrtare kombëtare dhe ndërkombëtare vetëm presidenti dhe Komiteti Ekzekutiv kanë të drejtën të përcaktojnë tarifën për televizionin publik apo privat, i cili do të transmetojë ndeshjet e volejbollit.
- 2.14 Kur një shoqatë sportive së cilës i është deleguar organizimi i një veprimtarie zyrtare kombëtare apo ndërkombëtare nga FSHV-ja kërkon që të transmetojë aktivitetin në një televizion tjetër lokal, KE mund ta miratojë atë vetëm pas aprovimit me shkrim nga operatori i kontraktuar nga FSHV.
- 2.15 Ndalohet kategorikisht, në çdo rast dhe për asnjë arsye prekja, kërcënimi apo fyerja e gjyqtarëve nga ana e trajnerit/res dhe çdo antari/e të skuadrës gjatë zhvillimit të ndeshjes. Me kërkesën e gjyqtarit të I-rë, vetëm kapiteni/nja i lojës ka të drejtë të komunikojë me gjyqtarin e I-rë. Në rast të mos respektimit të nenit 2.15 nga cdo anëtar i ekipeve, atëherë të gjithë ata do të jenë subjekt i vendimeve të Komisionit të Disiplinës, bazuar edhe në Kodin e Etikës.

KAPITULLI III

PJESËMARRJA DHE AKTIVIZIMI I SKUADRAVE DHE LOJTARËVE

NENI 3. Në veprimtaritë zyrtare kombëtare të volejbollit marrin pjesë skuadrat e shoqatave sportive, anëtarë ligjorë të FSHV-së, të caktuara sipas strukturës organizative e miratuar nga Komiteti Ekzekutiv i FSHV- sv, në përputhje me sezonin sportiv respektiv.

- 3.1 Sezoni sportiv përfshin gjithë veprimtaritë zyrtare kombëtare dhe ndërkombëtare të Superligës, kategorisë së I-rë dhe kategorisë së II-të, ligen amatore, etj, në përputhje me kalendarin sportiv të sezonit sportiv, miratuar nga Komiteti Ekzekutiv i FSHV-së.
- 3.2 Në aktivitetet zyrtare kombëtare në superligë dhe kategorinë e parë për meshkuj dhe femra nuk lejohen që një shoqatë sportive të marrë pjesë me dy ekipe me të njëjtin emer, pra ato duhet detyrimisht të marrin pjesë vetëm me një ekip.
 - 3.1.1 Ekipet e shoqatave sportive që marrin pjesë në kampionatet kombëtare janë të detyruara të marrin pjesë edhe në ndeshjet e kupës së Shqipërisë, kupës së Rinisë, kupës së FSHV-së, etj. Në rast se ndonjë shoqatë sportive nuk merr pjesë në aktivitetet e kupës së Shqipërisë, kupës së Rinisë dhe kupës së FSHV-së etj., do të gjobitet sipas akteve nënligjore nga 50.000 (pesëdhjetë mijë) deri në 80.000 (tetëdhjetë mijë) lekë.
 - 3.1.2 Në aktivitetet kombëtare e ndërkombëtare (zyrtare e miqësore) aktivizohen zyrtarë, trajnerë, sportistë e gjyqtarë me qëndrim të mirë moral dhe të padënuar nga Komisioni i Disiplinës apo

ndonjë organ tjetër i FSHV-së. Sezoni sportiv i aktiviteteve zyrtare kombëtare të volejbollit fillon me 1 shtator dhe mbaron me 31 gusht të vitit pasardhës. Për sportistin ose trajnerin që mund të pezullohet apo përjashtohet nga klubi apo shoqata duhet të njoftohet zyrtarisht sekretariati i FSHV.

- 3.3 Shoqatat sportive do të regjistrojnë (federojnë) dhe liçensojnë një numër të pakufizuar lojtarësh të rritur (meshkuj e femra), të rinjë/të reja (U-21 meshkuj dhe U-20 femra) para të rinjë (U-19 meshkuj dhe U-18 femra), p/para të rinjë (U-17 meshkuj dhe U-16 femra), fëmijë (U-15 meshkuj dhe U-14 femra) dhe mini volejbol fëmijë deri në 13 vjeç (meshkuj dhe femra) si në volejbol, ashtu edhe në Beach-volley. Minimumi i lojtarëve që mund të regjistrojë një ekip për të marrë pjesë në kampionatet kombëtare për të gjitha kategoritë e sipërpërmendura do të jetë 10. Shoqata apo klubi sportiv, i cili ka në listën e federimit më pak se 10 lojtarë, nuk do të lejohet të marrë pjesë në kampionatet kombëtare që do të organizojë FSHV-ja.
- 3.4 Në të gjitha ndeshjet zyrtare do të aktivizohen maksimumi 12 lojtarë, plus 1 ose 2 lojtarë libero.
- 3.5 Në ndeshjet me sistem grumbullimi, do të luajnë vetëm lojtarët që janë regjistruar ditën e parë të aktivitetit. Nuk lejohet regjistrimi apo ndryshimi i lojtarëve gjatë ditëve të zhvillimit të aktivitetit me sistem grumbullimi.
- 3.6 Lojtarët si meshkuj, ashtu edhe femra nuk lejohen të regjistrohen dhe aktivizohen brenda një sezoni sportiv njëkohësisht, në dy klube apo shoqata sportive, si brenda vendit, ashtu edhe jashtë vendit, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenet 4.7.5; 4.7.6; 4.8.2 të kësaj rregulloreje.
- 3.7 Në të gjitha veprimtaritë kombëtare brenda një sezoni sportiv, mosha e lojtarëve do të llogaritet vetëm me vitin e lindjes, sipas

federimit dhe liçensimit të sportistëve në fillim të sezonit sportiv.

- 3.7.1 Me skuadrat e të rinjëve marrin pjesë lojtarë deri në moshën 21 vjeç (U-21), ndërsa me të rejat deri në moshën 20 vjeç (U-20). Mosha e lojtarëve llogaritet me vitin e lindjes me 1 janar të çdo viti. Lartësia e rrjetës për meshkuj U-21 duhet të jetë 2,43 m dhe për femrat U-20 duhet të jetë 2.24 m. Lojtarët duhet të regjistrohen (federohen) dhe të liçensohen nga FSHV-ja.
- 3.7.2 Me skuadrat e para të rinjëve marrin pjesë lojtarë deri në moshën 19 vjeç (U-19), ndërsa me skuadrat e para të rejave marrin pjesë lojtarë deri në moshën 18 vjeç (U-18). Mosha e lojtarëve llogaritet me vitin e lindjes 1 janar të çdo viti. Lartësia e rrjetës është 2,43 m për meshkujt dhe 2,24 m për femrat. Lojtarët duhet të regjistrohen (federohen) dhe të liçensohen nga FSHV-ja.
- 3.7.3 Me skuadrat e para para të rinjë marrin pjesë lojtarë deri në moshën 17 vjeç (U-17), ndërsa me skuadrat e para para të rejave marrin pjesë lojtarë deri në moshën 16 vjeç (U-16). Mosha e lojtarëve llogaritet me vitin e lindjes me 1 janar të çdo viti. Lartësia e rrjetës është 2,43 m për meshkujt dhe 2,24 m për femrat. Lojtarët duhet të regjistrohen (federohen) dhe të liçensohen nga FSHV-ja.
- 3.7.4 Me skuadrat e fëmijëve marrin pjesë djem të moshës 15 vjeç (U-15) dhe vajza të moshës 14 vjeç (U-14). Mosha e lojtarëve llogaritet me vitin e lindjes, me 1 janar të çdo viti. Lartësia e rrjetës është 2,24 m për meshkujt dhe 2,15 m për femrat. Lojtarët duhet të regjistrohen (federohen) dhe të liçensohen nga FSHV-ja.
- 3.7.5 Në minivolejball marrin pjesë fëmijë meshkuj e femra deri në 13 vjeç. Mosha e lojtarëve llogaritet me vitin e lindjes me 1 janar të çdo viti. Lartësia e rrjetës si për meshkuj, ashtu edhe për femra

është 2,15 m. Lojtarët duhet të regjistrohen (federohen) dhe të liçensohen nga FSHV-ja.

- 3.8 Çdo shoqatë për pjesmarrjen në veprimtaritë zyrtare të volejbollit regjistrohet në çdo sezon me anën e “Formularit të Regjistrimit dhe Garancisë” dërguar nga sekretariati i FSHV-së. Formulari i plotësuar duhet të dorëzohet për miratim në sekretariatin e FSHV-së, 30 (tridhjetë) ditë para fillimit të veprimtarisë së parë sportive. Regjistrimi bëhet kundrejt pagesës së detyrimeve financiare pranë FSHV-së.
- 3.8.1 Çdo shoqatë sportive duhet të paguajë para fillimit të sezonit sportiv detyrimet financiare në bankën dhe numrin e llogarisë së FSHV.
- 3.8.2 Shoqata sportive e cila nuk do të paguajë detyrimet financiare sipas ekipeve respektive, nuk mund të marrë pjesë në veprimtaritë zyrtare të sezonit sportiv.
- 3.8.3 Detyrimet financiare janë të parimbursueshme. Çdo shoqatë sportive e cila ka konfirmuar me shkrim pjesmarrjen, ka likujduar pagesën përkatëse dhe tërhiqet nga aktiviteti nuk mundt’i kthehet shuma e paguar.
- 3.8.4 Shoqata sportive e cila do të ketë detyrime financiare të palikujduara karshi FSHV-së, nuk do të regjistrohet në sezonin e ri sportiv, pa likujduar më parë detyrimet e prapambetura, dhe do të gjobitet sipas akteve nënligjore 20.000 (njëzet mijë) lekë për moslikujdim në kohë të faturës të lëshuar nga FSHV-ja. Afati për likujdimin e faturës është 30 ditë nga data e marrjes në dorëzim.
- 3.8.4.1 Të gjitha shoqatat sportive që duan të marrin pjesë në sezonin sportive dhe që nuk dorëzojnë formularin në kohën e duhur sipas nenit 3.8 atëherë ato gjobiten në masën (20.000 lekë) dhe i jepet mundësia që të regjistrohen në sekretariatin e FSHV deri 25

ditë para fillimit të aktivitetit të parë që hap sezonin sportiv. Pas përfundimit të këtij afati asnjë skuadër nuk ka të drejtë të regjistrohet dhe të marrin pjesë në aktivitetet zyrtare kombëtare të sezonit sportiv. Skuadrat që nuk do të regjistrohen ose janë përjashtuar nga veprimtaritë zyrtare kombëtare nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në veprimtaritë ndërkombëtare zyrtare.

3.8.4.2 Gjatë veprimtarive kombëtare ose nderkombëtare brenda të njejtimit sezon sportiv, nuk lejohet që një skuadër të ndryshojë emrin e saj me të cilin ajo është regjistruar në fillim të sezonit sportiv.

3.8.4.3 Çdo skuadër pasi ka konfirmuar pjesëmarrjen në sezonin sportiv nëpërmjet “Formularit të Regjistrimit dhe Garancisë” në sekretariatit e FSHV-së, dhe tërhiqet pas hedhjes së shortit dënohet sipas akteve nënligjore me gjobë 30.000 (tridhjetë mijë) lekë, dhe vitin ku duhet të marrë pjesë duhet të likujdojë paradhënje, detyrimet financiare.

3.8.4.4 Çdo skuadër pasi ka konfirmuar pjesëmarrjen në sezonin sportiv nëpërmjet “Formularit të Regjistrimit dhe Garancisë” duhet të dorëzojë pranë sekretariatit të FSHV-se edhe dokumentat e mëposhtëm:

- Formularin A2
- Formularin A3
- Formularin A4
- Formularin A5
- Formularin A6
- Formularin A7/1 “Luaj pastër” (Anti doping AD)
- Formularin A 7/2 “Luaj pastër” (Anti manipulim AM)
- Listën e federimit për çdo ekip, të nënshkruar nga të gjithë pjesëmarrësit
- Siguracioni për secilin lojtar/e, trajner/re, zv/traner/re në shoqëri sigurimi.
- Foto në format dixhital
- Fotokopje dokument identifikimi (kartë, pasaportë), Fotokopje kontrate ose akt-marveshjeje.

- Fotokopje të dokumentacionit të shoqatës (akt themelimi, statutut të shoqatës dhe vendimi gjykatës)
Afati për dorëzimin e këtyre dokumentave është 20 ditë para fillimit të veprimtarisë së parë sportive të sezonit.

- 3.8.4.5 Periudha e miratimit të licencave është 15 ditë para fillimit të veprimtarisë së parë sportive. Të gjitha shoqatat sportive që nuk dorëzojnë në kohën e duhur dokumentat e nevojshme për licencimin do të gjobiten në masën (10.000 lekë).
- 3.8.5 Të gjithë lojtarët meshkuj (U-21; U-19; U-17; U-15) dhe femra (U-20; U-18; U-16; U-14) të cilët nuk janë të regjistruar në listat e federimit në fillim të sezonit sportiv, mund të regjistrohen me anën e “Listës shtesë të federimit”, në çdo kohë, deri me datën 31 janar të çdo viti, vetëm me skuadrën që ata janë regjistruar dhe aktivizuar në sezonin e fundit sportiv, si dhe në rast se lojtari/rja plotëson kërkesat në përputhje me nenin 3.6 dhe 3.8.6 të kësaj rregulloreje. Lojtarët mund të regjistrohen në një ekip apo shoqatë tjetër vetëm me anë të certifikatës së transferimit.
- 3.8.5.1 Të gjithë lojtarët meshkuj dhe femra, superligës dhe A1, përfshirë edhe lojtarët e huaj, duhet të regjistrohen (federohen) me ekipet e tyre respektive, për sezonin sportiv në periudhat: 1-7 shtator, dhe 1-31 janar. Ato duhet të regjistrohen në listat e federimit të ekipeve dhe të licënsohen nga FSHV-ja. Regjistrimi duhet të bëhet on-line brenda afateve të përcaktuara në këtë rregullore.
- 3.8.5.2 Të gjithë lojtarët meshkuj dhe femra të superligës dhe A1, të cilët nuk janë të regjistruar në listat e federimit të skuadrave në fillim të sezonit sportiv, mund të regjistrohen me anën e “listës shtesë të federimit” në çdo kohë, deri me datën 31 janar të çdo viti, vetëm me skuadrën që ata janë regjistruar dhe aktivizuar në sezonin e fundit sportiv. Regjistrimi duhet të bëhet on-line, duke likuajduar edhe tarifën përkatëse për data volley-in, listën e federimit etj. Si dhe në rast se lojtari/rja plotëson kërkesat në

perputhje me nenet 3.6 dhe 3.8.6 të kësaj rregulloreje. Lojtarët mund të regjistrohen në një ekip apo shoqatë tjetër vetëm me anë të certifikatës së transferimit.

- 3.8.6 Lojtarët meshkuj dhe femra, shqiptarë dhe të huaj nuk mund të aktivizohen në fazën finale të “Play-Off-it” (ndeshjet për vendin e I-rë dhe të II-të), të “Play-Out-it” pa qenë prezent (të pranishëm në fushën e lojës) në çdo ndeshje me skuadrat e tyre, në një minimum prej 5 (pesë) ndeshjesh të kampionatit kombëtar për fazën e “Play-Off-it”, dhe 3 (tre) ndeshjesh në kupë, për fazën finale të Kupës së Shqipërisë, të të njëjtit sezon sportiv. Për të rinjtë (U-21); (U-20), para të rinjë (U-19); (U-18), para para të rinjët (U-17); (U-16) dhe skuadrat e fëmijëve si meshkuj (U-15); (U-13), ashtu edhe femrat (U-14); (U-12) nuk lejohen të aktivizohen në fazën gjysëm finale dhe fazën finale, lojtarë të cilët nuk janë regjistruar (federuar) dhe liçensuar në fazën eliminatore të kampionateve të tyre respektive.
- 3.8.7 Gjatë veprimtarive kombëtare ose ndërkombëtare, zyrtare ose miqësore si kampionat kombëtar, kupa e Shqipërisë etj., për të rritur, të rinjë (U-21); (U-20) para të rinjë (U-19); (U-18); para para të rinjë (U-17); (U-16) dhe fëmijë meshkuj e femra të drejtën për t’u ulur në stolin e skuadrave e kanë deri në 5 (pesë) persona: trajneri/ja dhe 1 ose 2 zv/trajnerë, si dhe një mjek dhe një masazhator/e (fizioterapist/e). Të gjithë këto persona duhet të jenë njëkohësisht të federuar dhe të kenë liçencën brenda së njejtës skuadër. Vetëm kapiteni i skuadrës mund të zëvendësojë trajnerin ose zv/trajnerin në rast të mungesës së tyre.
- 3.9 Në të gjitha veprimtaritë zyrtare për të gjitha nivelet nuk lejohet që trajneri/ja apo zv/trajnerët e federuar dhe liçensuar me një skuadër të drejtojnë njëkohësisht një skuadër tjetër si nga një klub (shoqatë) sportive në një klub (shoqatë) sportive, ashtu si dhe të njejtit klub (shoqatë) sportive.

- 3.10 Nuk lejohet që në veprimtaritë për të gjitha nivelet rritur/rritura, rinjë (U-21)/reja (U-20) p/rinjë (U-19), p/reja (U-18), p/para rinjë (U-17), p/para reja (U-16) personat e regjistruar dhe licënsuar si trajnerë dhe zv/trajnerë të skuadrave, të jenë njëkohësisht lojtarë, apo gjyqtarë dhe të aktivizohen në veprimtaritë zyrtare të volejbollit brenda të njëjtit sezon sportiv.
- 3.10.1 Nuk lejohet ndryshimi i licensës nga trajner në lojtar apo anasjelltas, në të njëjtin ekip, brenda të njëjtit sezon sportiv.
- 3.10.2 Fizoterapisti i skuadrës duhet të ketë dëshminë përkatëse nga “Universiteti i Sporteve” ose nga institucione të njohura me ligj, që kanë kompetencën e lëshimit të dëshmimeve për fizioterapist.
- 3.11 Nuk lejohet që të gjithë lojtarët, e licënsuar pranë FSHV-së (në volejboll dhe beach-volley), të marrin pjesë në aktivitete, kupa ose turne të organizuar nga klube ose shoqata apo subjekte publike ose private të paautorizuara me shkrim nga sekretariati i FSHV-së. Në rast shkelje të këtij neni, atëhere ato do të jenë subjekt i Komisionit të Disiplinës.
- 3.12 Gjatë zhvillimit të veprimtarive kombëtare ose nderkombëtare, zyrtare ose miqësore si kampionat kombëtar, kupa e Shqipërisë etj., për të rinjë (U-21) e të reja (U-20), të drejtën për t’u ulur në stolin e skuadrave e kanë vetëm trajnerë e zv/trajnerë të kategorisë së tretë (më të lartë) dhe të dytë sportive, në volejboll, si dhe mjeku i skuadrës. Të gjithë këto persona duhet të jenë të federuar dhe të kenë licencën brenda të njëjtës skuadër. Në rast të mungesës së trajnerëve në aktivitetet për të rinjë e të reja, ata mund të zëvendësohen nga trajnerët e ekipeve të të Rriturve ose të Rriturave, brenda të njëjtit klub apo shoqatë sportive.
- 3.13 Në të gjitha veprimtaritë kombëtare zyrtare, lojtarët e të gjitha skuadrave duhet të paraqiten me uniforma të rregullta sportive

dhe me numrat 1-22 si para, ashtu dhe mbrapa fanellës sportive në përputhje me rregulloren teknike.

- 3.13.1 Nuk lejohet që në një ndeshje zyrtare volejboli të dyja skuadrat të kenë të njejtën ngjyrë në uniformat e lojës. Skuadra “mike” (udhëtuese) në kalendar është e detyruar të ketë uniformën e lojës të ndryshme nga skuadra kundërshtarë. Në rast të mos zbatimit të këtij rregulli, skuadra “mike” (udhëtuese) gjobitet 10.000 (dhjetëmijë) lekë.
- 3.13.2 Në fillim të çdo sezoni sportiv të gjithë ekipet pjesmarrëse në veprimtaritë kombëtare si kampionati kombëtar, kupa e Shqipërisë etj., duhet të paraqesin në FSHV 2 uniforma loje që do të luajnë në ndeshjet zyrtare, të cilat duhet të jenë të miratuara nga klubet/shoqatat e tyre sportive.
- 3.14 Të gjitha ekipet që duan të vendosin emrat e sponsoreve të tyre në fanellat sportive të skuadrave gjatë veprimtarive zyrtare, duhet të regjistrohen në sekretariatit e FSHV-së nëpërmjet formularit përkatës A5.
- 3.14.1 Nuk do të lejohet që ekipet në fanellat e tyre të kenë emra sponsorësh, të cilët nuk janë regjistruar në FSHV nëpërmjet formularit përkatës A5. Për ato të cilët nuk zbatojnë këtë rregullore do të merren këto masa:
- Për rastin e parë ekipi i cili ka shkelur këtë rregull do të gjobitet me 50.000 (pesëdhjetëmijë) lekë.
 - Për rastin e dytë kur i njeti ekip ka shkelur këtë rregull do të gjobitet me 100.000 (njëqindmijë) lekë dhe do humbë ndeshjen në tavolinë sipas rastit 0-3 (0 – 75), ose 0-2 (0-50).
- 3.15 Të gjitha skuadrat e/shoqatave sportive të vendit tonë që do të marrin pjesë në aktivitetet zyrtare të Kupave të Europës, korrespondencën me CEV (Konfederatën Europiane të Volejbollit) do ta bëjnë nëpërmjet sekretariatit të FSHV-së,

ndërsa korrespondencën me skuadrën mike dhe gjyqtarët e caktuar për ndeshje do ta bëjnë nëpërmjet shoqatës së tyre, sipas udhëzimeve dhe rregullores të përcaktuar nga CEV në sistemin on-line, të caktuar për klubet/shoqatat pjesëmarrëse.

- 3.16 Të gjitha shoqatat sportive që do të marrin pjesë në aktivitete zyrtare të kupave të Europës, duhet të konfirmojnë me shkrim në FSHV garancinë e pjesëmarrjes dhe duhet të ngurtësojnë në një bankë në emër të FSHV shumën prej 7,000 (shtatë mijë) euro si garanci financiare, para se ato të japin konfirmimin për pjesëmarrjen në aktivitetet për kupat e Europës. Shuma e mësipërme do të jetë e ngurtësuar deri në përfundimin e pjesëmarrjes së ekipit në aktivitetin ku ai merr pjesë.
- 3.16.1 KE bazuar në rregulloren e CEV ka të drejtën të pezullojë nga aktivitetet kombëtare zyrtare çdo shoqatë, e cila ka detyrime financiare të pa likujduara karshi CEV, për mos respektimin e rregullores ndërkombëtare në pjesëmarrjet e saj për kupat e Europës.
- 3.17 Për zhvillimin e veprimtarive ndërkombëtare me sistem grumbullimi do të përgjigjet shoqata sportive e cila ka garantuar me shkrim zhvillimin e veprimtarisë, duke marrë përsipër të gjitha detyrimet financiare dhe organizative për zhvillimin normal të veprimtarisë, në përputhje me standartet e kërkuara nga FIVB, CEV, BVA, dhe FSHV.
- 3.17.1 Çdo shoqatë sportive duhet të dërgojë me shkrim në FSHV kërkesën dhe garancinë financiare për pjesëmarrjen apo për organizimin e veprimtarisë ndërkombëtare në përputhje me pikën 3.16, jo më vonë se 15 ditë pas përfundimit të sezonit sportiv.
- 3.18 Në veprimtaritë zyrtare ndërkombëtare që do të zhvillohen në vendin tone, shoqata sportive pritëse duhet të likujdojë 1 (një)

ditë para zhvillimit të ndeshjes shpërblimet për grupin e gjyqtarëve, të cilat përmbledhin:

- Shpenzime për shpërblimin e gjyqtarit I-rë, të gjyqtarit të II-të dhe supervizorin në përputhje me tarifat e përcaktuara në rregulloret ndërkombëtare të aktiviteteve të CEV.
- Shpenzime për udhëtimin, hotelin, ushqimin për gjyqtarët dhe supervizorin.
- Shpenzime për shpërblimin e 2 sekretarëve, 4 anësorëve dhe 1 pikëshënuesi vendas, sipas tarifave të përcaktuara nga KE i FSHV-së.

- 3.19 Në veprimtaritë ndërkombëtare zyrtare shpërblimi për sekretarinë dhe gjyqtarët anësorë do të jetë sipas tabelës së shpërblimeve miratuar nga KE dhe në përputhje me kategorinë si gjyqtar.
- 3.20 Në veprimtaritë zyrtare kombëtare dhe ndërkombëtare shoqata sportive pritëse duhet të njoftojë mbi rezultatin e ndeshjes me e-mail në FSHV dhe CEV menjëherë pas përfundimit të saj.
- 3.21 Çdo shoqatë e re sportive është e detyruar që të paraqesë fotokopje të dokumentacionit të regjistrimit të saj nga gjykata kompetente në sekretariatit e FSHV-së për t'u regjistruar si antare dhe pjesëmarrëse në aktivitetet zyrtare të FSHV-së.
- 3.21.1 Pjesëmarrja e këtyre skuadrave në veprimtaritë zyrtare kombëtare do të fillojë nga kategoria më e ulët në një kategori më të lartë.
- 3.22 Nuk lejohet që gjatë veprimtarive zyrtare kombëtare brenda të njëjtit sezon sportive, dy skuadra të të njëjtit qytet (komune) të përfaqsohen me të njëjtin emër si brenda të njëjtës kategori dhe gjini, ashtu dhe në kategori e gjini tjetër.

- 3.23 Të gjitha ekipet, lojtarët apo trajnerët të cilët kanë detyrimeve karshi FSHV-së, nuk do të regjistrohen, liçensohen dhe akvizohen, pa shlyer më parë detyrimet e tyre si:
- Mungesa e dokumentacionit të rregullt fillestar (lista e regjistrimit, federimet, liçensimet, fotokopje të kontratave ose akt-marveshjeve, formularët, etj sipas nenit 3.8.4.4);
 - Moslikujdim i detyrimeve financiare brenda afatit të parashikuar karshi FSHV-së, (detyrime të palikujduara karshi FSHV-së, janë dhe të gjitha detyrimet e palikujduara të sezonit sportiv të mëparshëm).
 - Mosdorëzimi i bazës material të ekipeve kombëtare.
 - Mos likujdimi i sanksioneve të marra në sezonin e mëparshëm nga Komisioni i Disiplinës.

AKTIVITETET E BEACH - VOLLEY-it

- 3.24 Sezoni sportiv i beach-volley-it (volejbollit të Plazhit) fillon nga 1 maji deri më 30 shtator.
- 3.25 Në aktivitetet zyrtare të beach-volley-it mund të marrin pjesë çifte lojtarësh të shoqatave anëtare si për meshkuj ashtu edhe për femra nga i njëjti klub sportiv apo shoqatë sportive, si dhe çifte lojtarësh/esh nga klube e shoqata të ndryshme sportive, anëtare të FSHV-së. Standarti zyrtar i lojës së beach-volley-it për të gjitha aktivitetet zyrtare kombëtare dhe ndërkombëtare është 2 x 2 (lojtarë).
- 3.25.1 Një çift konsiderohet një ekip/skuadër. Çdo skuadër beach-volley përbëhet nga 2 (dy) lojtarë dhe 1 (një) trajner. Në aktivitetet zyrtare të beach-volley-it ekipet mund të paraqiten edhe vetëm me lojtarët.
- 3.26 Regjistrimi dhe liçensimi i lojtarëve në aktivitetet e beach-volley-it do të bëhet me license të veçantë pranë FSHV-së, sipas

njoftimit zyrtar nga ana e sekretariatit të FSHV-së, kundrejt taksës respektive për çdo lojtar.

- 3.27 Vendet e zhvillimit të aktiviteteve të beach-volley-it do të propozohen nga komisioni i “beach-volley-it” dhe miratohen nga Presidenti dhe Komiteti Ekzekutiv.
- 3.28 Komisioni i “beach-volley-it” harton çdo vit programin e aktiviteteve zyrtare kombëtare dhe ndërkombëtare dhe e dërgon atë në sekretariatit e FSHV-së. Programi i aktiviteteve zyrtare të beach-volley-it miratohet nga Presidenti dhe Komiteti Ekzekutiv.
- 3.29 Aktiviteti kombëtar zyrtar i beach-volley-it bëhet në përputhje me rregulloren teknike të beach-volley-it sipas standarteve të FIVB dhe CEV.
- 3.30 Aktivitetet zyrtare të beach-volley-it organizohen për kategoritë e mëposhtëme:
- Të rritur meshkuj dhe femra.
 - Aktivitete të moshes deri 22 vjeç (U-22) për meshkuj dhe femra.
 - Aktivitete të moshes deri 20 vjeç (U-20) për meshkuj e femra.
 - Aktivitete të moshes deri 18 vjeç (U-18) për meshkuj e femra.
- 3.31 Komisioni i beach-volley-it dhe sekretariati i FSHV-së propozojnë lojtarët që do të marrin pjesë në aktivitetet ndërkombëtare zyrtare të beach-volley-it. Pjesëmarrja dhe aktivizimi i tyre bëhet me miratimin e Presidentit dhe Komitetit Ekzekutiv.
- 3.32 Komisioni i beach-volley-it mund të organizojë dhe aktivitete promovionale me të gjitha moshat me standarte të njohura vetëm nga FSHV-ja, si “sand-volley” (volejboli i rërës), i cili do të luhet me 4 x 4 (lojtarë) meshkuj dhe femra, si dhe me ekipe miks.

KAPITULLI IV

TRANSFERIMI I LOJTARËVE DHE TRAINEREVE

TRANSFERIMI I LOJTARËVE DHE TRAINEREVE BRENDIA VENDIT

NENI 4. Të gjithë lojtarët, trenerët, meshkuj dhe femra me pasaportë shqiptare kanë të drejtë të transferohen (lëvizin) nga një shoqatë sportive në një tjetër shoqatë sportive, brenda vendit, sipas procedurave të parashikuar në këtë rregullore:

- 4.1 Sekretariati i FSHV legalizon transferimin e lojtarëve, trainereve meshkuj dhe femra brenda vendit në përputhje me 4 (katër) pikat e mëposhtëme:
- a. Çdo skuader ka të drejtë të marrë dhe të aktivizojë për një sezon sportiv lojtarë, trainere shqiptarë (numri i pakufizuar);
 - b. Për lojtarët, trenerët meshkuj dhe femra, të cilët nuk kanë kontratë individuale të noterizuar ose jo me ndonjë shoqatë sportive (në rastet e kontratave të firmosura nga të dy palët dhe me vulën e institucionit, shoqatës) këto lojtarë e trenerë do të konsiderohen të lirë;
 - c. Për lojtarë, trenerë meshkuj dhe femra të cilët kanë kontratë individuale të noterizuar ose jo (në rastet e kontratave të firmosur nga të dy palët dhe me vulën e institucionit shoqates) dhe të depozituara në sekretariatit e FSHV-së;
 - d. Lojtarët, trenerët meshkuj dhe femra të cilët kanë kontratë me 2 shoqata sportive, mosmarveshjet midis tyre t'i zgjidhin me mirëkuptim, dhe në të kundërt mund t'i drejtohen KAS-it ose në rrugë ligjore. Këto lojtarë e trenerë që kanë probleme nuk do të lejohen të luajnë dhe ektivizohen me asnjë shoqatë deri në zgjidhjen e mosmarveshjeve.

- 4.2 Transferimi (lëvizja) për të gjithë lojtarët, trainerët meshkuj dhe femra të cilët nuk do të kenë kontratë të noterizuar ose jo me klub shoqaten sportive, do të jetë konform ligjit për sportin dhe akteve nënligjore. Shoqata sportive që merr lojtarin, traineret paguan taksën në sekretariatit e FSHV prej 20.000 (njetetëmijë)lekë për çdo lojtar/e dhe për çdo trainer.
- 4.3 Kontratat për transferimin (lëvizjen) e lojtarëve brenda vendit, bëhet nga moshë 15-18 vjeç dhe 18-33 vjeç; si për meshkuj, ashtu edhe për femra dhe trainerë. Shoqatat sportive janë të detyruara të bëjnë kontrata individuale ligjore me sportistët, trainerët e tyre, që marrin pjesë në aktivitetet zyrtare të FSHV, konform ligjit për sportin dhe akteve nënligjore.
- 4.3.1 Në përfundim të çdo sezoni sportiv të gjithë lojtarët, meshkuj dhe femra të moshave 15-18 vjeç dhe 18-33 vjeç dhe trainerët, të cilët nuk do të kenë kontratë të noterizuar ose jo dhe të depozituar në sekretariatit e FSHV me shoqatat respektive të tyre, kanë të drejtën të transferohen (lëvizin) brenda vendit, me një kontratë të re duke përdorur “Çertifikatën e transferimit” sipas procedurave të parashikuara në këtë rregullore.
- 4.3.2 Shoqata që merr një lojtar/e, i cili nuk ka patur asnjëherë kontratë të mëparëshme, mund të bëjë me lojtarin kontratë të noterizuar dhe ta dorëzojë atë në sekretariatit e FSHV-së, duke fituar në këtë rast të drejtën e origjinës, administrimit dhe menaxhimit të lojtarit/es.
- 4.3.3 Në rast se shoqata sportive do të ketë kontratë të noterizuar ose jo me lojtarin/en e moshës 18-33 vjeç, trainerin/en dhe të depozituar në sekretariatit e FSHV-së, atëherë asnjë transferim nuk mund të legalizohet nga sekretariati i FSHV-së, pamirimitin zyrtar të shoqatës që disponon kontratën e lojtarit/es, trainerit/es duke respektuar kushtet e kontratave respektive.

- 4.4 Kontratat për transferimin (lëvizjen) e lojtarëve brenda vendit për moshat 15-18 vjeç do të nënshkruhen nga prindi apo kujdestari i njohur me ligj për këtë qëllim. Transferimi (lëvizja) e këtyre lojtarëve (meshkuj e femra bëhet pasi të kenë plotësuar “Çertifikatën e Transferimit” shoqata që merr lojtarin/en paguan në sekretariatit e FSHV-se takson prej 10.000 (dhjetëmijë) lekë.
- 4.4.1 Në rast se shoqata do të kenë kontratë të noterizuar me lojtarin/en e moshës 15-18 vjeç, nga prindi apo kujdestari i lojtarit/es i njohur me ligj dhe të depozituar në sekretariatit e FSHV-së, atëhere asnjë transferim nuk mund të legalizohet nga sekretariati i FSHV-së, pa miratimin zyrtar të klubit/shoqatës që disponon kontratën e lojtarit/es, duke respektuar kushtet sipas kontratës respektive të lojtarit/es.
- 4.4.2 Moshja e lojtarëve në të gjitha rastet përcaktohet vetëm sipas vitit të lindjes
- 4.4.3 Kontrata e moshës 15-18 vjeç quhet e përfunduar kur ajo përputhet me vitin e lindjes, mbyllet e sezonit sportiv, si dhe kur lojtari/ja nuk e rinovon atë. Në këtë rast lojtari/ja quhet lojtar/e i /e lirë dhe me kërkesën e tij/saj me shkrim, ai/ajo mund të regjistrohet dhe aktivizohet me ekipin që ai/ajo preferon.
- 4.4.3.1 Transferimi i lojtarëve të moshës 15-18 vjeç të cilët nuk kanë kontratë dhe nuk janë aktivizuar (federuar) me asnjë ekip për 2 (dy) sezone sportive, kanë të drejtë të regjistrohen (federohen) me çfardo ekipi apo shoqate sportive që deshiron, vetëm me anë të “Çertifikatës së Transferimit” lëshuar nga sekretariati i FSHV-së. Transferimi (lëvizja) bëhet pa asnjë detyrim financiar.
- 4.5 Transferimi i lojtarit/es me moshë nën 15 vjeç bëhet mbi bazën e dëshirës me shkrim të prindit apo kujdestarit të tij/saj të njohur me ligj, në 2 (dy) kopje. Një kopje i drejtohet shoqatës ku ai/ajo

dëshiron të aktivizohet dhe një kopje dorëzohet në sekretariatën e FSHV-së. Transferimi (lëvizja) bëhet pa asnjë detyrim financiar.

- 4.6 Transferimi i lojtarëve, trainereve brenda vendit, nga një shoqatë sportive në një klub/shoqatë tjetër sportive bëhet vetëm me anë të “Çertifikatës së transferimit” (formati zyrtar) lëshuar nga sekretariati i FSHV-së, për çdo sezon sportiv.
- 4.6.1 Proçedura e transferimit fillon nga shoqata sportive që do të marrë lojtarin/en, trainerin/en. Pas plotësimit të “Çertifikatës së transferimit” nga ana e lojtarit/es, trainerit/es, zyrtarizimit (firmë+vulë) nga shoqata sportive që merr lojtarin/en, trainerin/en dhe pagesës së taksës së detyrueshme në sekretariatën e FSHV-së, 20.000 (njëzetmijë) lekë, lojtarit/es apo trainerit/es i miratohet e drejta e transferimit.
- 4.6.2 “Çertifikate e transferimit” duhet të plotësohet në 4 kopje:
- 1-kopje (orgjinali) në FSHV;
 - 1-kopje lojtari/rja;
 - 1-kopje klubi/shoqata që merr lojtarin/ren.
 - 1-kopje shoqata që jep lojtarin/ren (kur lojtari ka kontratë të noterizuar me shoqatën sportive).
- 4.7 Kontratat për transferimin e lojtarëve brenda vendit bëhen në dy periudha:
- Periudha e parë nga 01 Korrik deri në 10 Shtator, ora 18.00. (Periudha e I-rë do të zbatohet vetëm për ato lojtarë me pasaportë shqiptare, që nuk janë federuar, nuk kanë marrë liçencë dhe nuk janë aktivizuar në asnjë skuader të Shqipërisë, brenda të njëjtit sezon sportiv).
 - Periudha e dytë nga 01 Janar deri 31 Janar, ora 18:00.
- 4.7.1 Një lojtar konsiderohet i transferuar kur largohet nga një shoqatë sportive në një shoqatë tjetër sportive. Çdo lojtar/re nuk mund të bëjë më shumë se 1 (një) kontratë brenda të njëjtit sezon sportiv.

- 4.7.2 Lojtari/rja i/e transferuar nuk kanë të drejtë të ndryshojnë shoqtën sportive brenda të njejtë sezon sportiv.
- 4.7.2.1 Transferimi i lojtarëve meshkuj e femra të moshës 18-33 vjeç, të cilët nuk kanë kontratë dhe nuk janë aktivizuar (federuar) me asnjë ekip për 2 (dy) sezone sportive kanë të drejtë të regjistrohen (federohen) me çfardo ekipi apo shoqatë sportive që dëshiron, vetëm me anë të “Çertifikatës së Transferimit” lëshuar nga Sekretariati i FSHV-së. Transferimi (lëvizja) bëhet pa asnjë detyrim financiar.
- 4.7.2.2 Transferimi i trainerëve meshkuj e femra nga një shoqatë në një shoqatë tjetër, të cilët nuk kanë kontratë dhe nuk janë aktivizuar (federuar) me asnjë ekip për 3 (tre) sezone sportive, kanë të drejtë të regjistrohen (federohen) me çfardo ekipi apo shoqate sportive që dëshirojnë, vetëm me anë të “Çertifikatës së Transferimit” lëshuar nga Sekretariati i FSHV-së. Transferimi (lëvizja) bëhet pa asnjë detyrim financiar.
- 4.7.2.3 Nuk lejohet që brenda një sezoni sportiv një trainer/re të transferohet nga një shoqatë apo klub sportiv në një shoqatë apo klub sportiv tjetër. Lëvizja e tyre nga një shoqate apo klub në një shoqatë apo klub tjetër do të bëhet vetëm me anë të “Çertifikatës së Transferimit të Trainerit/res”
- 4.7.2.4 Nuk lejohet që një trainer/re të jetë njëkohësisht trainer/re ose zv/trainer/re me një ekip tjetër meshkuj e femra si dhe me ekipet e të rinjëve (U-21 dhe U-20), para të rinjëve (U-19 dhe U-18), me ekipet e para/para të rinjëve (U-17 dhe U-16) me ekipet e fëmijëve meshkuj e femra.
- 4.7.2.5 Në rast se një trainer/re është regjistruar në një ekip në fillim të sezonit sportiv dhe deri në përfundim të fazës së parë të kampionatit kombëtar nuk është aktivizuar në asnjë ndeshje, në fillimin e fazës së dytë mundet të aktivizohet në ekipin që

dëshiron. Shoqata ose klubi sportiv që e merr duhet të plotësojë “Çertifikatën e Transferimit” të trenerit/res dhe të likujdojë shumën përkatëse në llogarinë e FSHV-së.

- 4.7.3 Lojtarët meshkuj dhe femra me moshë 33 vjeç e lart, të cilët nuk kanë kontratë të noterizuar ose jo me ndonjë shoqatë sportive, dhe si rrjedhim jo të depozituar në sekretariatit e FSHV-së, kanë të drejtë të lëvizin nga një shoqatë sportive në një klub/shoqatë tjetër sportive brenda vendit, pa asnjë detyrim financiar ndaj FSHV-së.
- 4.7.4 Pas përfundimit të procedurave të transferimit, sekretariati i FSHV-së nuk mban përgjegjësi për detyrimet që sportisti/ja, mund të ketë ndaj shoqatës sportive të mëparëshme, si dhe për detyrimet që dy shoqata sportive mund të kenë ndërmjet tyre.
 - 4.7.4.1 Lojtarët meshkuj e femra duke filluar nga mosha 14 deri ne 33 vjeç dhe mbi 33 vjeç, trenerët, të cilët lidhin dhe nënshkruajnë 2 ose më shumë kontrata ose aktmarveshje me 2 (dy) shoqata të ndryshme në të njëjtën periudhë kohe, dënohen sipas akteve nënligjore me 100.000 (njëqindmijë) lekë gjobë.
 - 4.7.4.2 Lojtarët meshkuj dhe femra që kanë lidhur aktmarveshje ose kontratë me një shoqatë sportive dhe nuk paguhen për 3 (tre) muaj rresht nga këto të fundit, akt-marveshja ose kontrata elidhur midis tyre do të konsiderohet e prishur (e përfunduar), mbasi kjo e fundit (shoqata) nuk ka plotësuar detyrimet sipas akt-marveshjes ose kontratës së lidhur.
- 4.7.5 Në fillim të sezonit sportiv, skuadrat e shoqatave të të gjitha niveleve për meshkuj dhe femra që nuk do të regjistrohen dhe liçensohen për pjesmarrjen e tyre në veprimtaritë zyrtare të FSHV-së, të gjithë lojtarët meshkuj dhe femra të këtyre skuadrave janë të lirë të regjistrohen, federohen dhe aktivizohen me cilën skuadër që ata dëshirojnë.

- 4.7.6 Gjatë sezonit sportiv në vazhdim në rast se një ose më shumë skuadra ndërpresin pjesmarrjen e tyre nga veprimtaritë zyrtare të FSHV-së, para 31 Dhjetorit, atëherë të gjithë lojtarët meshkuj dhe femra të këtyre skuadrave janë të lirë të regjistrohen dhe liçensohen me çdo skuader që ata preferojnë vetëm në periudhën 1-31 Janar.
- 4.7.7 Në rast se një ose më shumë skuadra ndërpresin pjesëmarrjen e tyre nga veprimtaritë zyrtare të FSHV-së gjatë sezonit sportive në vazhdim, pas 31 Dhjetorit, atëherë të gjithë lojtarët meshkuj dhe femra të këtyre skuadrave janë të lirë, por të drejtën për t'u regjistruar, liçensuar e aktivizuar me skuadrën që ata preferojnë e kanë vetën në sezonin e ri sportiv pasardhës.
- 4.7.8 Lojtarët meshkuj dhe femra të regjistruar në fillim të veprimtarive të organizuar nga FSHV-ja, të cilët deri me datën 31 Dhjetor nuk janë aktivizuar me ekipet e tyre respektive (ekipet e liçensuara) në asnjë ndeshje, kanë të drejtë që përperiudhën e mbetur të regjistrohen me çfardo ekipi apo shoqate sportive në periudhën 1-31 Janar, pasi të lëshohet leje kalimi me shkrim nga ekipi i regjistruar në fillim të sezonit sportiv. Ky do të konsiderohet transferim i lojtarëve (meshkuj e femra) dhe nga ana e ekipit të shoqatës që e regjistron (federon) duhet të likujdojë FSHV-në me taksën 20.000 lek për çdo lojtar/re.
- 4.7.8.1 Shoqatat sportive, mundet të liçensojnë (federojnë) lojtarë meshkuj dhe femra brenda ekipeve të tyre zinxhir edhe pas 31 Janarit, duke patur parasysh që ato të mos aktivizohen në fazat e play-off-it, play-aut-it dhe fazat finale të kampionateve të tyre respektive, por do duhet të likujdojnë tarifën përkatëse në FSHV për 10.000 (dhjetëmij) lek për çdo lojtar apo lojtare të liçensuar.
- 4.7.9 Lojtarët meshkuj e femra të moshës 15-18 vjeç dhe 18-33 vjeç e lart, nuk do të lejohen të transferohen e liçensohen nga një ekip

apo shoqatë në një ekip apo shoqatë tjetër, në rast se ka detyrime për uniformën e të tjera detyrime ndaj ekipit apo shoqatës që ishte i liçensuar më parë. Klubi apo shoqata ku ishte i liçensuar lojtari/ja duhet të lëshojë vërtetim me shkrim.

- 4.7.10 Lojtarët e ekipeve Kombëtare meshkuj e femra të moshës 15-18 vjeç dhe 18-33 vjeç e lart, nuk do të lejohen të transferohen e liçensohen nga një ekip apo shoqatë në një ekip apo shoqatë tjetër, në rast se ka detyrime për uniformën që duhet të kthehen në FSHV.

HUAZIMI I LOJTARËVE BRENDA VENDIT

- 4.8 Vetëm brenda fazes së parë të kampionatit kombëtar e në vazhdim për të rritur dhe të rritura, çdo klub apo shoqatë sportive mund të huazojë jo më shumë se 2 (dy) lojtarë/re nganjë klub apo shoqatë tjetër sportive brenda vendit. Pas përfundimit të fazës së parë të kampionatit, në vazhdim nuk lejohet huazimi i lojtarëve.
- 4.8.1 Komiteti Ekzekutiv i FSHV-së lejon huazimin (lëvizjen) e lojtarit vetëm pas aprovimit zyrtar me shkrim nga të dy klubet apo shoqatat sportive të interesuara.
- 4.8.2 Lojtari/ja i/e huazuar mund të kthehet brenda të njejtit sezon sportiv në shoqatën, që ai/ajo është regjistruar në fillim të sezonit sportiv, vetëm në periudhën 1 Janar – 31 Janar të të njejtit sezon sportiv.
- 4.8.3 Lojtari/ja i/e huazuar i/e cili/a nuk kthehet pas përfundimit të fazes së parë në shoqatën, që ai/ajo është regjistruar në fillim të sezonit sportiv, do të konsiderohet transferim i/e lojtarit/es brenda vendit, dhe bazuar në nenin 4.2 të kësaj rregulloreje klubi

apo shoqata që merr lojtarin/en paguan taksën në sekretariatit e FSHV-së prej 20.000 (njëzetmijë) lekë.

- 4.8.4 Lojtarët meshkuj e femra të moshës 18-33 vjeç e lart nuk lejohen të huazohen nga një ekip/shoqatë në një ekip/shoqatë tjetër në rast se ka detyrime për uniformën etj ndaj ekipit që ishte iliçensuar. Për ato lojtarë/e që kanë problem duhet merret vërtetim me shkrim nga klubi apo shoqata që ishte iliçensuar.
- 4.8.5 Lojtarët e ekipit kombëtar meshkuj e femra të moshës 18-33 vjeç e lart nuk lejohen të huazohen nga një ekip/shoqatë në një ekip/shoqatë tjetër pa shlyer detyrimet ndaj FSHV-së për uniformën etj.

TRANSFERIMI I LOJTARËVE E TRAINERE TË HUAJ NË SHQIPËRI

- 4.9 Çdo skuadër ka të drejtë të marrë dhe të aktivizojë lojtarë të huaj (numri i pakufizuar) me kontratë 1 vjeçare (për një sezon sportiv) ose me kontratë 6/mujore, me kushtin që gjithmonë në fushën e lojës, do të jenë 3 lojtarë të huaj. Raporti i lojtarëve në fushën e lojës (ndeshje) për të gjitha skuadrat pjesmarrëse në veprimtaritë zyrtare kombëtare, do të jetë: 3 lojtarë të huaj dhe 3 lojtarë me pasaportë shqiptare.
 - 4.9.1 Lojtarët meshkuj dhe femra me pasaportë Shqiptare dhe me origjinën e lojtarit/es së huaj, do të konsiderohen Shqiptarë, dhe transferimi i tyre në ekipet e shoqatat e vendit tonë do të konsiderohen si transferim i lojtareve brenda vendit dhe do të paguajnë tarifën prej 20.000 (njëzetmijë) lekë.
 - 4.9.1.1 Kontratat për transferime (marrjen) e lojtarëve të huaj bëhetvetëm në periudhën 01 Korrik - 31 Janar ora 18.00 (pas perfundimit të çdo sezoni sportiv, dhe brenda sezonit të ri sportiv). Brenda këtyre afateve duhet të përfundojë e gjithë

procedura e transferimit on-line me FIVB-në (Federata Botërore e Volejbollit) dhe lojtari/ja duhet të ketë “Çertifikatën Ndërkombëtare të Transferimit” (ITC) të lëshuar nga i vetmi organ kompetent, që është FIVB.

- 4.9.1.2 Në rast se një klub/shoqatë sportive aktivizon një lojtar të huaj pa përfunduar procedurën e marrjes së “Çertifikatës Ndërkombëtare të Transferimit” (ITC) gjohet sipas rregullores së FIVB-së me 30.000 (tridhjetmijë) Euro.
- 4.9.2 Transferimi në Shqipëri i lojtarëve me pasaportë të huaj dhe anëtarë të një federate tjetër volejboli bëhet vetëm me anë të procedurës on-line, përcaktuar nga FIVB (Electronic International Transfer).
 - 4.9.2.1 Vetëm pas përfundimit të procedurës së regjistrimit on-line në FIVB, marrjes së “Çertifikatës Ndërkombëtare të Transferimit” (ITC) dhe pagesës së taksës në sekretariatit e FSHV-së prej 30.000 (tridhjetmijë) lekë për të gjithë sezonin sportiv dhe 50.000 (poesdhjetmijë) lekë për një fazë (në rastin e fazes së dytë është edhe play-off-i), FSHV jep licencën e aktivizimit të lojtarit/es të huaj. Pas marrjes së licencës lojtari/rja duhet të veprojë në përputhje me nenin 3.6 të kësaj rregulloreje.
 - 4.9.2.2 Jashtë periudhave të përcaktuara në këtë rregullore sekretariati i FSHV-së nuk kryen veprime për transferimin e lojtarëve.
 - 4.9.2.3 Lojtarët e huaj meshkuj e femra të cilët do të aktivizohen me ekipet e shoqatave të vendit tone duhet jenë prezent në fushën e lojës minimalisht 5 (pesë) ndeshje zyrtare, për fazën e parë të kampionatit kombëtar apo ndeshje zyrtare për kupën e Shqipërisë.
- 4.9.3 Për aktivizimin e lojtarit/es të huaj në aktivitetet zyrtare ndërkombëtare shoqata që merr lojtarin duhet të paguajë në CEV

taksën e detyrueshme sipas rregullores së CEV-it. Pa këtë pagesë lojtari/ja nuk mund të aktivizohet në aktivitetet zyrtare ndërkombëtare.

- 4.9.4 Transferimi në Shqipëri i lojtarit/ëve me pasaportë amerikane dhe që është aktivizuar vetëm në kampionatet e Univerisiteteve në Amerikë bëhet vetëm me anë të “Çertifikatës së Transferimit për Lojtarë të Huaj” (formati zyrtar i FSHV-së).
- 4.9.5 Lojtari/ja me pasaportë Amerikane duhet të paraqesë në FSHV:
- a. Deklaratë të noterizuar nga Universiteti në Amerikë që është i/e lirë të aktivizohet dhe nuk është anëtar i Federatës Amerikane të Vollejbollit.
 - b. Pasaporta e lojtarit apo lojtares.
 - c. Deklaratë personale e lojtarit/es që shpreh dëshirën për t’u aktivizuar në Shqipëri dhe që nuk është anëtar i ndonjë federate tjetër.
- 4.9.5.1 Vetëm pas verifikimit të dokumentacionit dhe pagesës së taksës në FSHV prej 30.000 (tridhjetmijë) lekë për të gjithë sezonin dhe 50.000 (pesëdhjetmijë) lekë për një fazë (në rastin e fazesë dytë është edhe play-off), sekretariati i FSHV-së jep licensëne aktivizimit të lojtarit/es të huaj. Pas marrjes së licenses lojtari apo lojtarja duhet të veprojë në përputhje me nenin 3.6 të kësaj rregulloreje.
- 4.9.6 Transferimi në Shqipëri i lojtarit/ëve me pasaportë të shtetit të Kosovës bëhet vetëm me anë të “Çertifikatës Ndërkombëtare të Transferimit” (ITC) formati zyrtar i FIVB-së.
- 4.9.7 Lojtari/ët nga Kosova duhet të kryejnë të njëjtat procedura si të gjithë lojtarët e tjerë të huaj, deri në marrjen e “Çertifikatës Ndërkombëtare të Transferimit” (ITC) nga FIVB.

- 4.9.8 Vetëm pas verifikimit të dokumentacionit dhe pagesës së taksës në sekretariatit e FSHV-së prej 20.000 (njëzetmijë) lekë, FSHV jep licensën e aktivizimit të lojtarit/es nga Kosova. Pas marrjessë licenses lojtari apo lojtarja duhet të veprojë në përputhje me nenin 3.6 të kësaj rregulloreje.
- 4.9.9 Transferimi i trajnerëve të huaj në Shqipëri, përfshirë edhe traineret nga Kosova, bëhet në çdo periudhë të vitit në shoqatat apo klubet sportive të vendit tonë për periudhën një sezon sportive, duke likujduar tarifën përkatëse prej 50.000 (pesëdhjetëmijë) lekë, ndërsa për periudhën nga nga 01 Janari e në vazhdim do të likujdojë tarifën për 70.000 (shtatëdhjetëmijë) lekë.
- 4.9.10 Në çdo rast mund të bëhet edhe transferimi i trainerit të huaj pas datës 31 Janar (pasi kanë përfunduar transferimet) por shoqata që e merr atë duhet të likujdojë tarifën e transferimit për shumën 90.000 (nëntëdhjetëmijë) lekë.

KAPITULLI V

TRANSFERIMI I LOJTARËVE SHQIPTARË JASHTË SHTETIT

NENI 5. Çdo lojtar/e ka të drejtën të aktivizohet në një klub sportiv jashtë shtetit me kontratë, sipas procedurave të përcaktuara nga FIVB.

- 5.1 Transferimi i lojtarëve shqiptarë për jashtë shtetit bëhet me anë të procedurës on-line, e përcaktuar nga FIVB. FSHV bën regjistrimin e lojtarit/es në FIVB, pasi ka përfunduar marrëveshja me klubet respektive dhe janë kryer detyrimet karshi shoqatës sportive dhe FSHV-së. Për të marrë “Çertifikatën Ndërkombëtare të Transferimit” (ITC), klubi që merr lojtarin/en duhet të paguajë në sekretariatit e FSHV taksën sipas tarifës së përcaktuar nga CEV Kalkulator, për çdo sezon sportiv dhe për çdo lojtar/e. Pa paguar taksën e detyrueshme, sekretariati i FSHV-së nuk bën regjistrimin e lojtarit/es në FIVB për transferimin ndërkombëtar.
- 5.2 Transferimi i lojtarëve shqiptarë për jashtë shtetit do të bëhet vetëm nëse lojtari apo lojtarja nuk do të ketë detyrime ndaj klubeve apo shoqatave sportive, ku ishin të regjistruar (federuar).
- 5.3 Transferimi i lojtarëve shqiptarë për jashtë shtetit, të cilët janë anëtar të ekipeve kombëtare, do të bëhet vetëm në rast se lojtari apo lojtarja nuk ka detyrime të pa shlyera ndaj FSHV-së.

KAPITULLI VI

KLASIFIKIMI

NENI 6. Klasifikimi i skuadrave në përfundim të veprimtarive zyrtare kombëtare bëhet në bazë të renditjes sipas rezultateve të arritura nga ekipet pjesmarrëse, në përputhje me strukturën e veprimtarive të miratuar nga Komiteti Ekzekutiv i FSHV-së.

Të gjitha shoqatat dhe skuadrat sportive duhet të njihen një muaj para fillimit të sezonit sportiv për mënyrën e organizimit dhe klasifikimin në veprimtaritë zyrtare kombëtare.

- Për çdo ndeshje të fituar me rezultatin 3-0 dhe 3-1; skuadra merr 3 (tre) pike.
- Për çdo ndeshje të fituar me rezultatin 3-2: skuadra merr 2 (dy) pikë.
- Për çdo ndeshje të humbur me rezultatin 3-2: skuadra merr 1 (një) pikë.
- Për çdo ndeshje të humbur me rezultatet 0-3 dhe 1-3 skuadra merr 0 (zero) pikë.

6.1 Në rastet kur dy ose më shumë skuadra rezultojnë me pikë të barabarta, atëherë për klasifikimin e tyre do të vendoset sipas renditjes së mëposhtëme alfabetike:

- a. Mbi bazën e numrit më të madh të ndeshjeve të fituara. Fiton skuadra që ka numrin më të madh të ndeshjeve të fituara.
- b. Në rast se barazimi vazhdon, atëherë do të vendoset mbi bazën e koeficientit më të madh që del nga raporti i seteve të fituara me ato të humbura, të grumbulluara në të gjitha ndeshjet.p.sh: Skuadra A ka fituar 12 sete dhe ka humbur 8 sete; skuadra B ka fituar 14 sete dhe ka humbur 10 sete;

Koeficienti i skuadrës **A është $12 : 8 = 1,5$** , ndërsa koeficienti i skuadrës **B është $14 : 10 = 1,4$** . Fiton skuadra që ka koeficientin më të madh.

- c. Në rast se barazimi vazhdon, atëhere do të vendoset mbi bazën e koeficientit më të madh që del nga raporti i pikëve të fituara me ato të humbura, të grumbulluara në të gjitha ndeshjet. Fiton skuadra me koeficientin më të madh.
- d. Në rast se barazimi vazhdon, atëhere fituesja përcaktohet mbi bazën e rezultateve të ndeshjeve direkte ndërmjet skuadrave me pikë të barabarta.
- e. Në rast se barazimi vazhdon, atëhere **fituesja përcaktohet me golden set (me 15 pikë)**

6.1.1 Në fazën eliminatore të kupës së Shqipërisë si për meshkuj, ashtu edhe për femra kur luajnë dy ekipe midis tyre A (ekipi që është më lart në klasifikim) dhe B (ekipi që është më poshtë në klasifikim), dhe ndeshja e parë ka përfunduar me rezultatin 3-0, në favor të ekipit A, dhe ndeshja e dytë përfundon me rezultatin 3-1 në favor të ekipit B. Në këtë rast në bazë të nenit 6 të kësaj rregulloreje të dy ekipet kanë marrë nga 3 pikë. Ndeshja e parë do të luhet në fushën e ekipit B, ndërsa ndeshja e dytë në fushën e ekipit A. Për të përcaktuar ekipin fitues dy skuadrat duhet të zhvillojnë një golden set me 15 pikë në fushën e ekipit pritës, i cili në rastin tonë është ekipi A.

6.2 Në të gjitha aktivitetet që ndeshjet zhvillohen me dy sete të fituara, duke përfshirë edhe ato të cilat bëhen me sistem grumbullimi klasifikimi bëhet si më poshtë:

- a. Skuadra që fiton ndeshjen me rezultatin 2-0 dhe 2-1 merr dy pikë në klasifikim
- b. Skuadra që humb ndeshjen me rezultatin 0-2 dhe 1-2 merr 0 pikë në klasifikim.

Në rast se barazimi vazhdon klasifikimi i skuadrave do të bëhet në bazë të pikëve a,b,c dhe d të nenit 6 dhe 6.1 të kësaj rregulloreje, duke marrë parasysh fitoret, koeficientin e seteve dhe pikëve etj.

KAPITULLI VII

DËNIMET

NENI 7. Në të gjitha rastet e shkëljes së rregullore së brendëshme dhe rregullore teknike të lojës, komisioni i disiplinës dhe KE kanë të drejtën të japin dënime të ndryshme për skuadra, individë pjesëmarrës në veprimtaritë zyrtare.

- 7.1 Për mosparaqitje në ndeshje të veprimtarive zyrtare skuadra merr 0 (zero) pikë dhe gjobitet sipas akteve nënligjore me 60.000 (gjashtëdhjetëmijë) lekë.
- 7.2 Në rastet kur ndeshja humbet për arsye të shkëljes së rregullore, skuadra që e ka shkelur atë merr 0 pikë, rezultati përfundimtar i seteve do të jetë 0-3, rezultati i pikëve 0-75 dhe do të gjobitet sipas akteve nën ligjore me 60.000 (gjashtëdhjetëmijë) lekë.
 - 7.2.1 Kur një skuadër braktis ndeshjen e një veprimtarie në të gjitha kategoritë (të rritur/a meshkuj dhe femra, të rinjë/a U-21 dhe U-20, para të rinjë/a U-19 dhe U-18, para/para të rinjë/a U-17 dhe U-16, si dhe fëmijë U-15 dhe U-14 etj), skuadra që ka braktisur atë merr 0 (zero) pikë dhe rezultati përfundimtar i seteve të pa luajtura ose të ndërprera është sipas rasteve 0-25 ose 0-15. Rezultaet e seteve të luajtura mbeten ato të regjistruara në protokollin e ndeshjes. Ekipi që ka braktisur ndeshjen gjobitet sipas akteve nënligjore me 100.000 (një-qindmijë) lekë.
- 7.3 Një skuadër që humbet dy ndeshje me 0 (zero) pikë për mosparaqitje gjatë veprimtarive zyrtare kombëtare, i hiqen të gjitha pikët në ndeshjet e luajtura dhe skuadra s'kualifikohet nga veprimtaria zyrtare, si dhe gjobitet sipas akteve nënligjore me 100.000 (njëqindmijë) lekë. Në rast të përsëritur gjobitet sipas

akteve nënligjore me 200.000 (dyqindmijë) lekë deri në përjashtim.

- 7.4 Në rast se një skuadër nuk paraqitet në një nga ndeshjet e fazave “play-off”, “play-out” dhe finale të kupës së Shqipërisë, ajo skualifikohet nga kampionati kombëtar, dhe kupa e Shqipërisë dhe gjobitet sipas akteve nënligjore 300.000 (treqindmijë) lekë.
- 7.4.1 Në rast se një lojtar aktivizohet në veprimtaritë zyrtare kombëtare në kundërshtim me nenin 3.6 të kësaj rregulloreje, skuadra me të cilën ai/ajo aktivizohet s’kualifikohet nga aktivitetet kombëtare dhe gjobitet sipas akteve nënligjore me 200.000 (dyqindmijë) lekë.
- 7.4.2 Në përputhje me nenin 7.4.1 lojtari/ja i/e aktivizuar në këtë mënyrë dënohet me përjashtim nga të gjitha veprimtaritë zyrtare kombëtare dhe ndërkombëtare për një periudhë 1 (një) vjeçare dhe gjobitet me 100.000 (njëqindmijë) lekë.
- 7.4.3 Në rast se një skuadër nuk paraqitet në një nga ndeshjet e fazave 1/4, 1/2 dhe finale ajo s’kualifikohet nga aktivitetet kombëtare dhe gjobitet sipas akteve nënligjore me 300.000 (treqindmijë) lekë.
- 7.4.4 Në rast se një lojtar/e aktivizohet në veprimtaritë zyrtare kombëtare në kundërshtim me nenet 3.3; 3.5; 3.7.1; 3.7.2; 3.7.3; dhe 3.7.4 të kësaj rregulloreje, pra nuk është i/e regjistruar (federuar) në listat përkatëse të ekipeve, skuadra me të cilën ai/ajo aktivizohet i humbet ndeshjet. Skuadra që ka shkelur rregullores merr 0 (zero) pike, dhe rezultati përfundimtar i seteve do të jetë 0 -3 dhe ai i pikëve do të jetë 0- 75. Skuadra që ka aktivizuar lojtarin/en në kundërshtim me rregulloren gjobitet sipas akteve nënligjore me 60.000 (gjashtëdhjetëmijë) lekë.

- 7.5 Në të gjitha veprimtaritë zyrtare me sistem grumbullimi, kupa e Shqipërisë, kupa e FSHV, etj, skuadra e cila ka konfirmuar pjesëmarrjen dhe nuk paraqitet në ndeshjen e parë, përjashtohet nga veprimtaria dhe gjobitet sipas akteve nënligjore me 200.000 (dyqindmijë) lekë.
- 7.5.1 Në të gjitha veprimtaritë me sistem grumbullimi, skuadra e cila ka konfirmuar pjesëmarrjen dhe nuk paraqitet ndeshjen e parë, përjashtohet nga veprimtaria dhe gjobitet sipas akteve nënligjore me 100.000 (njëqindmijë) lekë.
- 7.5.2 Në rast se një skuadër ka konfirmuar pjesëmarrjen, nuk paraqitet në ndeshjen e kampionatit përjashtohet nga veprimtaria dhe gjobitet sipas akteve nënligjore me 100.000 (njëqindmijë) lekë.
- 7.6 Për çdo karton të kuq që merr lojtari, dënohet sipas Rregullores Teknike dhe gjobitet sipas akteve nën-ligjore me 3.000 (tremijë) lekë.
- 7.7 Për çdo karton të kuq që merr trajneri dënohet sipas Rregullores Teknike dhe gjobitet sipas akteve nën-ligjore me 5.000 (pesëmijë) lekë.
- 7.8 Për çdo karton të kuq që merr zv/trajneri dënohet sipas Rregullores Teknike dhe gjobitet sipas akteve nënligjore me 5.000 (pesëmijë) lekë.
- 7.9 Për çdo karton të kuq që merr mjeku apo masazhatori dënohet sipas Rregullores Teknike dhe gjobitet sipas akteve nënligjore me 5.000 (pesëmijë) lekë.
- 7.9.1 Kur një lojtarë/e merr njëkohësisht karton të verdhë dhe karton të kuq bashkë (në një dorë) dënohet sipas Rregullores Teknike dhe gjobitet sipas akteve nënligjore me 8.000 (tetëmijë) lekë.

- 7.9.2 Kur një trajner merr njëkohësisht karton të verdhë dhe karton të kuq bashkë (në një dorë) dënohet sipas Rregullores Teknike dhe gjobitet sipas akteve nënligjore me 10.000 (dhjetëmijë) lekë dhe dënohet me pezullim për 2 (dy) ndeshjet e rradhës.
- 7.9.3 Kur mjeku apo masazhatori i një skuadre merr njëkohësishtkarton të verdhë dhe karton të kuq bashkë (në një dorë) dënohet sipas Rregullores Teknike dhe gjobitet sipas akteve nënligjore me 10.000 (dhjetëmijë) lekë.
- 7.9.4 Kur një lojtarë/e merr njëkohësisht karton të verdhë dhe karton të kuq bashkë (të ndara në dy duart) dënohet sipas Rregullores Teknike, dhe gjobitet sipas akteve nënligjore me 10.000 (dhjetëmijë) lekë dhe nuk aktivizohet në 3 ndeshjet pasardhëse.
- 7.9.5 Kur një trajner/e merr njëkohësisht karton të verdhë dhe karton të kuq bashkë (të ndara në dy duart) dënohet sipas Rregullores Teknike, dhe gjobitet sipas akteve nënligjore me 15.000 (pesëmbëdhjetëmijë) lekë dhe nuk aktivizohet në ndeshjen pasardhëse.
- 7.9.6 Kur mjeku apo masazhatori i një skuadre merr njëkohësishtkarton të verdhë dhe karton të kuq bashkë (të ndara në dy duart) dënohet sipas Rregullores Teknike, dhe gjobitet sipas aktevenënligjore me 15.000 (pesëmbëdhjetëmijë) lekë dhe nuk aktivizohet në ndeshjen pasardhëse.
- 7.9.7 Për çdo denim të dhënë lojtarit/es, trajnerit/es ose çdo anëtar i skuadrës që dënohet, duhet të dorëzojë licensën personale në tavolinën e sekretarisë së ndeshjes.
- 7.9.8 Çdo lojtar/e, trajner/e ose ndonjë anëtar i skuadrës nuk mund të aktivizohet në ndeshjen pasardhëse pa shlyer detyrimin financiar në llogarinë e FSHV-së sipas detyrimit përkatës dhe të rimarrë licensën e tij/saj.

- 7.9.8.1 Dënimet do të zbatohen për të gjithë personat e licencuar dhe të regjistruar në ndeshjet zyrtare.
- 7.9.8.2 Pagesa e dënimeve bëhet individualisht nga çdo person që ndërshkohet me to.
- 7.9.8.3 Dënimet për lojtarët, trajnerët, zv/trajnerët apo anëtarët e licencuar të skuadrave pjesëmarrëse në ndeshjet zyrtare mund të jepen dhe pas përfundimit të ndeshjes, në rast të veprimtarive të ndryshme antisportive, në kundërshtim me rregulloren e lojës së volejbollit.
- 7.9.8.4 Dënimet që mund të marrin klubet/shoqatat sportive, lojtarët, trajnerët, zv/trajnerët, zytarë, gjyqtarë apo anëtarë të tjerë të licencuar në sekretariatit e FSHV-së në fund të sezonit sportive do të aplikohen në fillim të sezonit të ri sportiv.
- 7.9.8.5 Asnjë subjekt i dënuar nuk mund të marrë pjesë në aktivitetet zyrtare kombëtare, derisa të shlyejë dënimin e marrë nga organet respektive të FSHV-së.
- 7.9.8.6 Të gjithë trajnerët, zv/trajnerët, mjekët, masazhatorët apo përfaqësues të shoqatave sportive, që do të veprojnë në kundërshtim me nenin 2.15 të kësaj rregolloreje do të dënohen nga Komisioni i Disiplinës me pezullim të përkohëshëm apo të përherëshëm nga aktivitetet zyrtare të volejbollit dhe do të gjobiten me vlerën nga 5.000 (pesëmij) deri në 50.000 (pesëdhjetëmijë) lekë.
- 7.9.8.7 Kur ekipi pritës dhe organizator i aktivitetit nuk siguron praninë e forcave të sigurisë (polici private, polici bashkiake, polici rendi), dhe mjekut në ndeshje brenda 30 (tridhjetë) minutave nga orari i fillimit të saj, humbet ndeshjen 0 -3 dhe rezultati i pikëve

0 – 75, merr 0 (zero) pike në klasifikim dhe dënohet sipas akteve nënligjore me 30.000 (tridhjetëmijë) lekë.

7.9.8.8 Kur ekipi prites dhe organizator i aktivitetit nuk siguron mbledhësit e topave në ndeshjet e superligës për ndeshjet e parë dënohet sipas akteve nën-ligjore me gjobë për 10.000 (dhjetëmijë) lekë, në rast përsëritje dënohet sipas akteve nënligjore me 50.000 (pesëdhjetëmijë) lekë dhe në rast se këto nuk sigurohen për herë të tretë, do të dënohet sipas akteve nënligjore me 100.000 lekë.

KAPITULLI VIII

REKLAMIMI I NDESHJES

NENI 8. Reklamimet do të merren parasysh vetëm kur ka shkelje të Rregullores Teknike dhe asaj të brendshme të FSHV.

- 8.1 Kur një skuadër reklamon një ndeshje, duhet të njoftojë menjëherë pas mbarimit të saj gjyqtarin e parë dhe reklamimin me shkrim duhet t’ja paraqesë gjyqtarit të parë brenda 30 minutave nga përfundimi i ndeshjes.
- 8.2 Reklamimin e bën vetëm kapiteni i skuadrës. Dokumentin e firmosur nga kapiteni i skuadrës, gjyqtari i parë i’ bashkangjit protokollit të ndeshjes, të cilin e dorëzon në sekretariatit e FSHV-së.
- 8.3 Reklamimi në çdo rast bëhet kundrejt pagesës me vlerë 5.000 (pesëmijë) lekë, brenda 48 orëve nga dita e parë e punës, pas ndeshjes, ekipi që ka bërë reklamimin duhet të kryejë pagesën në numrin e llogarisë së FSHV-së.
- 8.4 Në rast të mos kryerjes së kësaj pagese sipas pikes 8.3, atëhere kërkesa për reklamim nuk shqyrtohet.
- 8.5 Për reklamimin, gjyqtari i parë vë në dijeni menjëherë edhe kapitenin e skuadrës kundëstare.
- 8.6 Për gabimet në protokollin e ndeshjes nuk pranohet asnjë reklamim, por do të vendoset sipas Rregullores Teknike, që për çdo gabim duhet të ndreqet menjëherë, që në momentin e konstatimit.

KAPITULLI IX

GJYTARËT, DELEGATI TEKNIK DHE KRYEGJYQTARI

NENI 9. Gjyqtarët e volejbollit janë persona individualë, të cilët në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje mund të kërkojnë aderimin e tyre si gjyqtarë në sekretariatit e FSHV-së. Gjyqtarët gjatë drejtimit të ndeshjeve janë persona zyrtarë publikë dhe si të tillë ata mbrohen nga “Ligji për sportin” në ushtrimin e detyrës së tyre.

- 9.1 Kriteret për t’u regjistruar si gjyqtar volejboli në FSHV janë:
- Të ketë arsim të lartë ose të jetë student duke vazhduar atë. Përparësi do të kenë ish-volejbollistë, ish- trajnerë, mësues të edukimit fizik me specialitet volejbollin, si dhe studentë të Universitetit të Sporteve. Gjithashtu përparësi do të kenë kandidatet femra.
 - Të mos ketë qenë i dënuar për vepra penale apo i përjashtuar nga ndonjë institucion publik apo privat për abuzime dhe qëndrim moral të dobët.
 - Të jetë jo më i vogël se 18 vjeç dhe jo më i madh se 35 vjeç.
 - Të mos ushtrojë njëkohësisht detyra si trajner apo lojtar.
 - Të ketë njohuri në gjuhën angleze
 - Të njohë përdorimin e disa programeve në kompjuter.
- 9.2 Gjyqtarët e ndeshjeve të volejbollit janë pjesë e strukturës së sekretariatit të FSHV-së.
- 9.2.1 Pranimi për të qenë gjyqtar volejboli bëhet mbi bazën e dëshirës dhe kërkesës me shkrim të çdo individit, drejtuar Komisionit Tekniko-Arbitrar. Komisioni bazuar në kriteret e kësaj

rregulloreje mund ta refuzojë ose ta pranojë kërkesën e kandidatit/es.

- 9.2.2 Pasi ka marrë kërkesën me shkrim nga kandidati/ja dhe të gjithë dokumentacionin e nevojshëm në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje komisioni Tekniko-Arbitral pas miratimit nga sekretariati i FSHV-së i vë në dispozicion kandidatit/es kontratën tip që rregullon marrdhëniet juridike ndërmjet palëve. Kontrata fillimisht është një vjeçare dhe duhet të firmoset individualisht nga çdo kandidat/e.
- 9.2.3 Kontrata mund të jetë subjekt i ndryshimeve si pasojë e ndryshimit të bazës ligjore. Vetëm Presidenti dhe KE kanë të drejtën të miratojnë ose të anullojnë pjesë të ndryshme të kontratës në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
 - 9.2.3.1 Pas miratimit nga Presidenti dhe KE të gjithë gjyqtarët duhet duhet të bëjnë siguracionin e jetës pranë një shoqërie të sigurimeve, para fillimit të sezonit të ri.
 - 9.2.3.2 Para fillimit të sezonit të ri, pas miratimit nga Presidenti dhe KE të gjithë gjyqtarët duhet duhet të bëjnë liçensimin në sekretariatit e FSHV-së sipas tarifës së përcaktuar në këtë rregullore, për çdo sezon sportiv.
- 9.3 Të drejtën për të drejtuar ndeshje zyrtare volejboli e ka çdo gjyqtar në Republikën e Shqipërisë, i cili është i regjistruar, i liçensuar në FSHV dhe me moshë deri në 65 (gjashtëdhjetë e pesë) vjeç.
 - 9.3.1 Mosha llogaritet sipas vitit të lindjes.
- 9.4 Presidenti dhe KE i FSHV-së pas propozimit nga Komisioni Tekniko-Arbitral ka të drejtë të japë kategoritë e gjyqtarëve dhe të pajisë çdo gjyqtar me liçencë sipas kategorisë përkatëse:

- a. Gjyqtar i kategorisë së parë
 - b. Gjyqtar i kategorisë së dytë
 - c. Gjyqtar i kategorisë së tretë
- 9.4.1 Të gjithë gjyqtarët e anëtarësuar rishtazi, pas sezonit të tyre të parë automatikisht marrin kategorinë e tretë me propozim të delegatëve teknik në Komisionin Tekniko-Arbitral.
- 9.4.2 Kategoria e dytë i jepet gjyqtarit/es me propozim të Komisionit Tekniko-Arbitral dhe miratohet nga Komiteti Ekzekutiv i FSHV-së.
- 9.4.3 Miratimi për marrjen e kategorisë së dytë do të bëhet vetëm pas përfundimit me sukses të kursit përkatës dhe plotësimit të paktën 3 (tre) sezoneve sportive të aktivizimit të tij si gjyqtar loje me kategorinë e tretë.
- 9.4.4 Titulli gjyqtar i kategorisë së parë jepet me propozim të Komisionit Tekniko-Arbitral dhe miratohet nga Komiteti Ekzekutiv i FSHV-së.
- 9.4.5 Propozimi për marrjen e kategorisë së parë do të bëhet vetëm pas përfundimit me sukses të kursit përkatës dhe plotësimit të paktën 4 (katër) sezoneve sportive të aktivizimit të tij si gjyqtar loje me kategorinë e dytë.
- 9.4.6 Të gjithë kandidatët duhet të kalojnë nga kategoria më e ulët e gjykimit në atë më të lartë.
- 9.4.7 Një gjyqtar/re nuk mund të fitojë një kategori më të lartë pa pasur më parë kategori më të ulët.
- 9.5 Të gjithë personat që do të fitojnë të drejtën për të qenë gjyqtarë të ndeshjeve të volejbollit, detyrimisht duhet t'i nënshtrohen kurseve dhe programeve të kualifikimit dhe rikualifikimit, në

teori dhe praktikë, për të drejtuar në nivele sa më të larta ndeshjet e volejbollit.

- 9.6 Komisioni Tekniko-Arbitral prezanton çdo katër vjet programin e kualifikimit të gjyqtarëve. FSHV duhet të sigurojë organizimin çdo 2 vjet të kurseve, programeve për gjyqtarët të cilët kërkojnë të fitojnë kategorinë e dytë dhe të parë.
 - 9.6.1 FSHV-ja organizon dhe mbulon shpenzimet e kurseve dhe programet e kualifikimit të cilat mund të drejtohen nga lektorë dhe specialist të fushës së gjykimit në volejball (specialist shqipëtar dhe të huaj), të cilët propozohen nga Komisioni Tekniko-Arbitral dhe miratohen nga Komiteti Ekzekutiv dhe sekretariati i FSHV-së.
 - 9.6.2 Vlerësimi i çdo kandidati/e do të bëhet nga grupi i caktuar nga Komisioni Tekniko-Arbitral i FSHV dhe miratimi përfundimtar do të bëhet nga Komiteti Ekzekutiv i FSHV-së.
 - 9.6.3 Liçencat për çdo gjyqtar miratohen e firmosen nga Presidenti i FSHV-së ose Sekretari i Përgjithshëm.
 - 9.6.4 Për kurset dhe programet për marrjen e kategorive, të gjitha shpenzimet për organizimin, bazën materiale, pagesën e lektorëve, dhe drejtuesëve të programit mbulohen nga FSHV.
 - 9.6.5 Çdo kandidat/e që do të regjistrohet në kurset e kategorizimit duhet të paguajë shumën sipas akteve nënligjore.
 - 9.6.6 Shpenzimet për udhëtimin veshmbathjen, fjetjen dhe ushqimin i përballon vetë kandidati/ja.
- 9.7 Komiteti Ekzekutiv i FSHV-së dhe Komisioni Tekniko-Arbitral përcaktojnë programin dhe personat që do të mbajnë kursin për

gjqtarët e volejbollit, për rinovimin e liçencës së kategorisë së parë, si gjyqtar.

- 9.7.1 Të gjithë gjyqtarët/et e kategorisë së parë janë të detyruar të marrin pjesë në kursin e rinovimit të liçencës për të mbajtur kategorinë e parë si gjyqtar. Kursi do të jetë teoriko-praktik dhe do të zhvillohet të paktën një herë në tre vjet.
- 9.7.2 Gjyqtari/ja që nuk do të marrë pjesë në kursin për rinovimin e liçencës si gjyqtar i kategorisë së parë, nuk do t'i rinovohet liçenca e kategorisë së parë. Gjithësesi ai/ajo do të aktivizohet në aktivitetet zyrtare të volejbollit si gjyqtar i kategorisë së dytë.
- 9.7.3 Të gjithë gjyqtarët që kanë fituar titullin “gjyqtar ndërkombëtar” janë të detyruar një herë në 2 (dy) vjet të marrin pjesë si lektorë dhe të kontribuojnë në mënyra të ndryshme duke dhënë eksperiencën e tyre, në kurset e rikualifikimit për rinovimin e liçencës zyrtare për gjyqtarët e FSHV-së.
- 9.7.4 Pas përfundimit të çdo kursi kualifikimi dhe rikualifikimi sekretariati i FSHV-së lëshon dëshminë respektive. Dëshmia bazuar në rezultatet e kursit firmoset nga Presidenti, Sekretari i Përgjithshëm dhe Kryetari i Komisionit Tekniko-Arbitral.
- 9.7.5 Për çdo kategori tjetër të drejtën e liçencës respektive e lëshon vetëm Presidenti dhe Sekretari i Përgjithshëm, bazuar në kushtet e kësaj rregulloreje.
- 9.8 Komisioni Tekniko-Arbitral ka të drejtën të propozojë kandidaturat e gjyqtarëve që do të marrin pjesë në kurset e kualifikimit ndërkombëtar, sipas kërkesave dhe kritereve të përcaktuara nga FIVB.

- 9.8.1 Çdo kandidat/e potencial duhet të ketë njohuri të gjuhës angleze dhe ta ketë të mbrojtur atë me dëshmi të njohur në vendt e BE- së.
- 9.8.2 Të gjitha kandidaturat për pjesmarrjen në kualifikimet ndërkombëtare miratohen nga Komiteti Ekzekutiv i FSHV-së.
- 9.9 Komisioni Tekniko-Arbitral me miratimin e Komitetit Ekzekutiv ka të drejtë të ndërtojë komisionet e gjyqimit të ndeshjeve të volejbollit për të gjithë gjyqtarët që janë regjistruar dhe liçensuar në sekretariatit e FSHV-së.
- 9.9.1 Kryetarët e komisioneve të gjyqtarëve në të gjithë vendin, propozohen nga Komisioni Tekniko-Arbitral dhe miratohen nga Presidenti dhe Komiteti Ekzekutiv i FSHV-së.
- 9.9.2 Të gjithë komisionet e gjyqtarëve, për të gjitha ndryshimet organizative të tyre duhet të njoftojnë Komisionin Tekniko-Arbitral dhe në sekretariatit e FSHV-së 30 (tridhjetë) ditë para.
- 9.10 Delegatët teknik të ndeshjeve të volejbollit janë pjesë e strukturës së sekretariatit të FSHV-së.
- 9.10.1 Delegati teknik në veprimtaritë kombëtare, ushtron të drejtën e kontrollit për zbatimin e rregulloreve dhe udhëzimeve të nxjerra nga sekretariati i FSHV-së.
- 9.10.2 Presidenti, Komiteti Ekzekutiv miratojnë listen emrore dhe numrin e delegatëve teknikë që do të aktivizohen për çdo sezon sportiv.
- 9.10.3 Kriteret për të qenë Delegat Teknik i FSHV:
- Të ketë qenë gjyqtar, lojtar ose trajner me ekipet kombëtare.
 - Të ketë arsim të lartë ose të jetë specialist me eksperience në volejboll.

- c. Të njohë procedure e fillimit dhe mbarimit të lojës dhe aktivitetit.
 - d. Të mos jetë anëtar i ndonjë klubi apo shoqate sportive.
 - e. Të mos ketë konflikt interesash me të qenit delegate teknik i FSHV-së.
 - f. Për aktivizimin në aktivitetet ndërkombëtare duhet të njohë shumë mire gjuhën angleze.
 - g. Të jetë i angazhuar për të plotësuar çdo detyrë të ngarkuar nga Komiteti Ekzekutiv i FSHV dhe sekretariati i FSHV.
- 9.10.4 Delegatë teknikë mund të jenë dhe anëtarët e Komisionit Tekniko-Arbitral, të miratuar nga Presidenti dhe Komiteti Ekzekutiv.
- 9.10.5 Delegati teknik nuk mund të jetë një person që në të njejtën kohë është trajner apo zv/trajner aktiv, dhe lojtar aktiv.
- 9.11 Lista e federimit të gjyqtarëve dhe delegatëve teknikë plotësohet sipas kërkesave të sekretariatit të FSHV-së, nga komisioni Tekniko-Arbitral. Kjo listë dorëzohet në sekretariatit e FSHV-së 30 ditë para fillimit të sezonit të ri sportiv.
- 9.12 Lista e federimit të gjyqtarëve dhe delegatëve teknikë miratohet nga Presidenti dhe Komiteti Ekzekutiv, si dhe publikohet nga sekretariati i FSHV-së në web site-in e FSHV-së.

KAPITULLI X

MENAXHIMI I LOJËS NGA GJYQTARËT, KRYEGJYQTARI DHE DELEGATI TEKNIK

NENI 10. Për drejtimin e ndeshjes gjyqtarët (kryegjyqtari dhe delegati teknik sipas rastit) mbështeten në Rregulloren Teknike, Rregulloren e Brendëshme, si dhe në të gjitha ndryshimet e bëra dhe të dërguara zyrtarisht me shkrim nga sekretariati i FSHV-së.

- 10.1 Komisioni Tekniko-Arbitral vë në dispozicion të sekretariatit të FSHV-së gjyqtarë të kategorisë ndër-kombëtare, të kategorisë së I-rë, II-të dhe III-të për veprimtaritë zyrtare kombëtare dhe ndërkombëtare, për çdo sezon sportiv.
- 10.2 Gjyqtaria për një ndeshje përbëhet nga zyrtarët e mëposhtëm:
 - a. Gjyqtari i parë
 - b. Gjyqtari i dytë
 - c. Sekretari i ndeshjes
 - d. Katër (dy) gjyqtarë anësorë
 - e. Në veprimtaritë e FIVB, botërore dhe ato zyrtare, është e detyrueshme edhe një ndihmës sekretar
 - f. Një pikëshënues
- 10.3 Të drejtat dhe përgjegjësitë apo detyrat e çdo anëtari të trupës gjykuese janë të shprehura qartë në rregulloren e lojës dhe duhet të plotësohen me rigorozitet nga çdo anëtar i trupës gjykuese.
- 10.4 Komiteti Ekzekutiv dhe sekretariati i FSHV-së mund të caktojnë, delegat teknik (në veprimtaritë më të rëndësishme kombëtare) apo kryegjyqtar (në veprimtaritë me sistem grumbullimi), të cilët ushtrojnë të drejtën e kontrollit për

zbatimin e rregullores së brendëshme dhe asaj të lojës dhe të gjitha udhëzimeve të nxjerra nga sekretariati i FSHV-së.

- 10.5 Gjyqtarët që do të drejtojnë ndeshjet nominohen nga komisioni Tekniko-Arbitral dhe miratohen nga sekretariati i FSHV-së. Sekretarët, ndihmës sekretarët dhe pikashënuesit caktohen nga sekretariati i FSHV-së.
- 10.5.1 Klubet/shoqatat sportive nuk kanë të drejtë për asnjë arsye dhe në asnjë rast të bëjnë zëvendësimin e gjyqtarëve të caktuar nga komisioni Tekniko-Arbitral dhe të miratuar nga sekretariati i FSHV më parë.
- 10.5.2 Në veprimtaritë me sistem grumbullimi kryegjyqtari dhe gjyqtarët që drejtojnë ndeshjet caktohen nga Komisioni Tekniko-Arbitral dhe miratohen nga sekretari i përgjithshëm i FSHV-së. Caktimi i gjyqtarëve për drejtimin e ndeshjeve bëhet nga kryegjyqtari.
- 10.6 Gjyqtarët, duhet të jenë të pranishëm në pallatet apo sallat sportive (në dhomat e xhveshjes) 40 (dyzet) minuta para fillimit të ndeshjes dhe 30 (tridhjetë) minuta para fillimit të ndeshjes duhet të jenë të pranishëm në fushën e lojës me uniformë për të zbatuar me përpikmëri protokollin e lojës.
- 10.7 Sekretari i ndeshjes, delegati teknik apo edhe kryegjyqtari (nese ka) duhet të jenë të pranishëm 45 (dyzetepesë) minuta parafillimit të ndeshjes për të përmbushur në kohë detyrat e tyre për mbarëvajtjen sa më të mirë të ndeshjes.
- 10.8 Gjyqtarët dhe delegati teknik nuk duhet të lejojnë që brenda fushës së lojës të futen persona të tepërt, në kundërshtim me ato që përcakton Rregullorja Teknike e lojës.

- 10.9 Delegati teknik apo gjyqtari i parë në mungesë të tij duhet të sigurohet që përpara fillimit të ndeshjes forcat e sigurisë (polici private, polici bashkiake apo polici rendi) dhe mjeku nga ekipi pritës janë prezent në fushë në momentin e fillimit të protokollit zyrtar të ndeshjes.
- 10.10 Në rast se në një ndeshje mungojnë gjyqtarët e caktuar, veprohet si më poshtë:
- Kur mungon gjyqtari i parë, atë e zëvendëson gjyqtari i dytë dhe gjyqtari i dytë caktohet nga vendi pritës, i cili duhet të jetë i federuar dhe të ketë liçencë.
 - Kur mungon gjyqtari i dytë atë e zëvendëson një gjyqtartjetër i vendit pritës, i cili duhet të jetë i federuar dhe të ketë liçencë.
 - Kur mungojnë të dy gjyqtarët, atëhere ndeshjen do ta drejtojnë 2 gjyqtarë të vendit pritës, të cilët duhet të jenë të federuar dhe të kenë liçencë.
 - Zbatimi i pikave a, b dhe c do të bëhet 30 minuta pas orës së caktuar për fillimin e ndeshjes.
- 10.11 Gjyqtari i parë dhe delegati teknik i ndeshjes, në rast të mosparaqitjes së njëres skuadër në orarin e caktuar kanë të drejtë:
- Të shtyjnë orarin e fillimit të ndeshjes vetëm 30 minuta nga orari i caktuar në pritje të skuadrës tjetër, duke qenë të pranishëm në fushën e lojës.
 - Në rast se njera skuadër nuk paraqitet në fushën e lojës brenda këtyre 30 minutave, ndeshja fitohet aforfe 3 - 0 dhe 75 - 0 nga skuadra e pranishme në fushë dhe skuadra e cila nuk u paraqit gjobitet me 50.000 (pesëdhjetëmijë) lekë.
- 10.12 Kryegjyqtari ose delegati teknik, 60 minuta pas përfundimit të ndeshjes njofton me telefon ose e-mail mbi rezultatin e ndeshjes në sekretariatën e FSHV-së dhe në Komisionin e Medias dhe Komunikimit.

- 10.12.1 Kryegjyqtari ose delegati teknik, jo më vonë se 1 (një) ditë pas përfundimit të ndeshjes dërgon në sekretariatit e FSHV-së relacionin mbi zhvillimin e veprimtarisë, klasifikimin, protokollet, reklamimet, aktivizimin e lojtarëve, trajnerëve dhe gjyqtarëve.
- 10.12.2 Në veprimtaritë zyrtare ku nuk është cakruar kryegjyqtar ose delegat teknik, gjyqtari i parë i ndeshjes do të ndjekë të njëjtën procedure si në nenet 10.12 dhe 10.12.1.
- 10.13 Kur protokollit i ndeshjes nuk plotësohet në mënyrë elektronike (plotësohet me dorë) duhet të plotësohet me kujdes dhe të jetë i lexueshëm, duke respektuar të gjitha kërkesat e Rregullores Teknike. Ai plotësohet në 3 kopje, nga të cilat origjinali dërgohet në FSHV, kopja e dytë skuadrës fituese dhe kopja e tretë skuadrës humbëse.
- 10.14 Sekretari i ndeshjes ose Pikashënuesi, 60 minuta pas përfundimit të ndeshjes dërgojnë me e-mail ose me aplikacione të tjera telefonike (si viber apo what's app) rezultatin e ndeshjes, foto ose video të xhiruara nga ndeshja në Komisionin e Medias dhe Komunikimit.
- 10.15 E drejta për të drejtuar ndeshjet në veprimtaritë zyrtare kombëtare mund të pezullohet për gjyqtarë të veçantë në këto raste:
- Kur gjyqtari nuk regjistrohet apo nuk ka marrë licencën zyrtare në FSHV para fillimit të veprimtarisë së parë zyrtare kombëtare. Gjyqtari në këtë rast pezullohet për një fazë të sezonit sportiv dhe gjobitet sipas akteve nënligjore 5.000 (pesëmijë) lekë.
 - Kur gjyqtari paraqitet me vonesë në ndeshje, në kundërshtim me pikën 10.6 dënohet për 2 (dy) ndeshjetpasardhëse.

- c. Kur nuk paraqitet pa asnjë arsye madhore në ndeshjen zyrtare i caktuar nga sekretariati i FSHV-së dënohet me 3 (tre) ndeshjet pasardhëse. Në rast përsëritje dënohet për një fazë dhe gjobitet sipas akteve nënligjore 10.000 (dhjetëmijë) lekë.
- d. Kur pa arsye dhe pa vënë në dijeni Komisionin Tekniko – Arbitral, gjyqtari largohet për një periudhë prej 6 muash, atëherë ai automatikisht nuk gëzon të drejtën e aktivizimit në veprimtaritë zyrtare kombëtare të sezonit sportive dhe dotë ulet 1 (një) kategori si gjyqtar.
- e. Kur pa arsye mungon 1 sezon sportive ai/ajo skualifikohet për 2 vjet dhe ulet 2 (dy) kategori si gjyqtar.
- f. Kur për drejtim të dobët, i cili ndikon drejtëpërsëdrejti në rezultatin përfundimtar të ndeshjes, gjyqtari pezullohet me 3 (tre) ndeshje nga veprimtaria zyrtare kombëtare, dhe në rast përsëritje pezullohet me 5 (pesë) ndeshje nga veprimtaria zyrtare kombëtare dhe nëse përsëritet sërish brenda të njejtë sezon atëherë ulet me 1 (një) kategori si gjyqtar.
- g. Kur shkel rregulloren teknike dhe atë të brendëshme, kur fillon lojën me vonesë, kur nuk zbaton detyrat e tij para dhe pas ndeshjes, kur paraqitet me uniformë jo të rregullt, kur lejon sjelljet e lojtarëve që janë në kundërshtim me rregulloren apo kodin e etikës, kur vonon informacionin, kur dërdon me vonesë ose humb protokollin e ndeshjes, pezullohet nga 1 (një) deri në 3 (tre) ndeshje mund të gjobitet nga 5.000 (pesëmijë) deri në 10.000 (dhjetëmijë) lekë.
- h. Kur para, gjatë ose pas ndeshjes vepron në mënyrë të qëllimëshme, në kundërshtim me Kodin e Etikës, duke prishur imazhin e FSHV-së, e cila mund të sjellë vonesë në fillimin e ndeshjes apo anulimit të saj, përjashtohet nga veprimtaritë zyrtare kombëtare dhe ndërkombëtare, për një periudhë nga 1 deri 2 vjet, ulet 1 (një) kategori si gjyqtar dhe dënohet me gjobë nga 50.000 (pesëdhjetë mijë) – 100.000 (njëqindëmijë) lekë.

- 10.16 Një gjyqtar i çdo kategorie që kalon trajner apo lojtar pranë klubi/shoqate sportive në kategorinë e parë, të rinjë/a U-21, U-20, para të rinjë/a U-19, U-18, para/para të rinjë/a U-17, U-16, fëmijë U-15 dhe U-14, nuk ka të drejtë të aktivizohet për sa kohë është trajner apo lojtar.

KAPITULLI XI

KATEGORIZIMI I TRAJNERËVE

NENI 11. Presidenti dhe Komiteti Ekzekutiv i FSHV ka të drejtë të japë kategoritë përkatëse të trajnerit/es të volejbollit dhe për këtë çdo trajner/e pajiset me liçencën përkatëse.

- 11.1 Komiteti Ekzekutiv i FSHV akordon tre kategoritë për trajnerët si më poshtë:
- Trajnerë/e i kategorisë së **parë** (kategoria më e ulët sipas FIVB-se)
 - Trajnerë/e i kategorisë së **dytë** (kategoria e njetë sipas FIVB-se)
 - Trajnerë/e i kategorisë së **tretë** (kategoria më e lartë sipas FIVB-se)
- 11.2 Për skuadrat e fëmijëve deri në moshën 15 vjeç propozohet trajner/e i kategorisë së parë, pas plotësimit të 2 (dy) sezoneve sportive si zv/trajnerë/e me këto moshë. Komisioni Teknik dhe Sekretari i Përgjithshëm miratojnë kategorinë e tretë sportive, duke vlerësuar trajnerin/en në përputhje me tre pikat e mëposhtme:
- Numri i lojtarëve të seleksionuar meshkuj apo femra, perspektiva e tyre.
 - Kushtet e infrastrukturës dhe baza materiale në dispozicion.
 - Sasia e stërvitjeve javore dhe objektivat që trajneri/rja synon të arrijë.
- 11.3 Për skuadrat e para të rinjëve (U-19), para të rejave (U-18), të rinjëve (U-21) dhe të rejave (U-20) deri në moshën 21 vjeç propozohet trajnerë/e i kategorisë së **dytë**, e më lart bazuar në

rezultatit e fituar në kursin e kualifikimit teoriko-praktik për trajnerë/e, si dhe plotësimin të 3 (tre) sezoneve sportive si zv/trajnerë/e me këto moshë.

11.4 Për skuadrat e të Rriturve e të Rriturave mbi moshën 21 vjeç e lart propozohet trajnerë/e i kategorisë së **tretë**, bazuar në rezultatit e fituar në kursin e kualifikimit teoriko-praktik për tranerë/re, si dhe pas plotësimin të 4 (katër) sezoneve sportive si zv/trajnerë/e me këto skuadra.

11.4.1 Komiteti Ekzekutiv i FSHV dhe Universiteti i Sporteve përcaktojnë programin dhe personat që do të mbajnë kursin për trajnerë volejbollit, për rinovimin e licencës së kategorisë së parë sportive. Të gjithë trajnerët janë të detyruar të marrin pjesë në kursin e rinovimit të licencës një herë në 4 (katër) vjet për të rifituar kategorinë e parë sportive. Kursi do të jetë teoriko- praktik.

11.5 Të gjithë trajnerët që kanë fituar licencën nga FIVB të nivelit të parë dhe të dytë, janë të detyruar që një herë në 4 (katër) vjet të marrin pjesë në kurset e rikualifikimit për rinovimin e licencës. Presidenti dhe Komiteti Ekzekutiv kanë të drejtë të ulin një kategori të trajnerit/es, në rast të mos pjesëmarrjes së tij në kursin e rikualifikimit, për rinovimin e licencës.

11.5.1 Kurset e kualifikimit dhe të rikualifikimit për trajnerë/e të kategorisë së dytë dhe të tretë organizohen në bashkëpunim me Universitetin e Sporteve të Tiranës si dhe specialistëve të huaj të njohur nga CEV dhe FIVB, mbi bazën e programeve të caktuara, në teori dhe praktikë.

11.5.2 Pas përfundimit të çdo kursi kualifikimi dhe rikualifikimi sekretariati i FSHV-së lëshon dëshminë respektive. Dëshmia bazuar në rezultatet e kursit firmoset nga Presidenti dhe Sekretari i Përgjithshëm.

- 11.6 Për çdo kategori tjetër të drejtën e liçencës respektive e lëshon vetëm Presidenti dhe Sekretari i Përgjithshëm, bazuar në kushtet e kësaj rregullore.
- 11.7 Kohëzgjatja e kurseve është në varësi të programeve që do të zhvillohen në përputhje me kategorit e ndryshme.
 - 11.7.1 Kurset i zhvillojnë pedagogë të volejbollit, specialistë, trajnerë, ekspertë vendas dhe të huaj (të njohur nga CEV), të cilët i propozon Komisioni Teknik i FSHV-së dhe i miraton Presidenti dhe Komiteti Ekzekutiv i FSHV.
 - 11.7.2 Vlerësimi për çdo trajnerë/e e bën komisioni i caktuar nga Komiteti Ekzekutiv dhe ky komision ia përcjell dokumentacionin përkatës sekretariatit të FSHV-së.
- 11.8 Çdo kandidat që do të regjistrohet në kurset e kategorizimit duhet të paguajë sipas akteve nënligjore 5.000 (pesëmijë) lekë deri në likuidimin e plotë të shpenzimeve për kualifikimin nga FSHV-ja.
 - 11.8.1 Të gjitha shpenzimet për udhëtim, veshmbathje, fjetje e ushqim i ka në ngarkim kandidati.
 - 11.8.2 Në kurset e kategorizimit kanë të drejtë të marrin pjesë candidate që kanë diplomën e universitetit të Sporteve ose diplomë të arsimit të lartë. Përparësi kanë ish volejbollistë të diplomuar në Universitetin e Sporteve, specialiteti volejball.
 - 11.8.3 Kandidatë me diplomë të arsimit të mesëm kanë të drejtë të marrin vetëm kategorinë e parë dhe të dytë sportive. Përparësi do të kenë volejbollistët dhe sportistët.

- 11.8.4 Të gjithë kandidatët duhet të kalojnë nga kategoria më e ulët deri në kategorinë e tretë. Nuk mund të fitohet kategoria më e lartë pa pasur më parë kategorinë më të ulët.
- 11.8.5 Të gjithë trajnerët që marrin Çertifikatën e Nivelit të dytë të FIVB-së, fitojnë kategorinë e parë si trajnerë/e, vetëm kur ata punojnë si trajnerë pranë ekipeve të volejbollit.
- 11.8.6 Personat të cilët kanë mbaruar studimet në Universitetin e Sporteve, ose Institutin e Lartë të Kulturës Fizike dhe Sporteve u njihet kategoria e parë (sipas FIVB-së), kategoria më e ulët si trajnerë në volejball.

KAPITULLI XII

DOKUMENTACIONI I SHOQATAVE SPORTIVE, TRAJNERË DHE GJYQTARËVE

NENI 12. Çdo shoqatë sportive duhet të ketë dhe të depozitojë në FSHV në fillim të çdo sezoni sportive, formularët model të FSHV-së të kërkuara sipas kësaj rregulloreje:

- a. Formularin e regjistrimit dhe garancisë të shoqëruar me kontratën respektive të noterizuar.
 - b. Listën e regjistrimit (federimit) të skuadrës të nënshkruar identikisht nga çdo lojtarë/e, trajnerët, zv/tra-jnerët, mjeku, shoqata sportive dhe të vulosur.
 - c. Kontratat e noterizuara ose akt-marveshje të lojtarëve me të gjithë moshat, trajner/re.
 - d. Çertifikatë mjeksore për lojtarët/et dhe trajnerët/et.
 - e. Çertifikatë e transferimit të lojtarit/es.
 - f. Siguracionin e jetës për çdo lojtarë/e, trajnerë/e, nga shoqëria sigurimit.
 - g. Listën e personave anëtarë të skuadrës, si zyrtarë, menaxherë, sponsorë.
 - h. Fotokopje të një dokumenti të vlefshëm identifikimi si: pasaportë ose kartë identiteti ose çertifikatë nga e-Albania (jo më e vjetër se një muaj nga data e lëshimit).
 - i. Foto në format pasaporte, format dixhital.
 - j. Formulari “luaj pastër” (AD dhe AM)
- 12.1 Shoqata Sportive duhet të ketë dokumentacionin e mëposhtëm:
- a. Dokumentacionin ligjor të regjistrimit në gjykatë, statutin, aktin e themelimit, vendim gjykate.
 - b. Statusin dhe rregulloren e brendëshme të FSHV-së.

- c. Rregulloren teknike të FSHV, (model i FIVB).
 - d. Rregulloren zyrtare të zhvillimit të aktiviteteve të sezonit sportiv.
 - e. Rregulloren teknike të beach-volley-it.
 - f. Të gjithë korespondencën zyrtare me FSHV.
 - g. Kontratat ose aktmarveshjet individuale të lojtarëve/e, trainerëve me shoqatën e tyre, si dhe aktmarveshje të ndryshme që kanë lidhje me veprimtaritë zyrtare të volejbollit.
- 12.2 Trajnerët duhet të kenë dokumentacionin e mëposhtëm:
- a. Programin e stërvitjes së skuadrës.
 - b. Planin perspektiv 2 – 4 vjeçar.
 - c. Planin organizativ vjetor të ndeshjeve dhe stërvitjes.
 - d. Planin javor të shpërndarjes së ngarkesave stërvitore.
 - e. Planin ditor të stërvitjeve.
 - f. Evidencën e kontrollit të stërvitjeve.
 - g. Evidencën e frekuentimit të stërvitjeve.
 - h. Evidencën statistikore të ndeshjeve.
 - i. Evidencën e përgaditjes teorike.
 - j. Evidencën e lojtarëve të perspektivës dhe lojtarëve të talentuar.
- 12.3 Listat e federimit të skuadrave pjesëmarrëse në veprimtari të zyrtare kombëtare përmban këto të dhëna: Emër dhe mbiemër, datëlindja, lartësia trupore, numri i kartës së identitetit, numri i licencës, firma e lojtarit/es.
- 12.4 Lista e federimit (regjistrimit) nënshkruhet nga çdo lojtarë/e. Për lojtarët/et që nuk kanë firmosur listën e federimit brenda afateve të përcaktuara, do të konsiderohen të pa federuar dhe nuk do të pajisen me licencë për t'u aktivizuar në ndeshje.

- 12.5 Lista e federimit pasi të jetë firmosur nga mjeku (specialist) zyrtarizohet (firmë dhe vulë) nga Presidenti ose sekretari ekzekutiv i shoqatës saportive.
- 12.6 Në listen e federimit shënohet trajneri/ja dhe 2 zv/trajnerët, të cilët miratohen nga FSHV-ja, për të drejtuar skuadrën në ndeshje.
- 12.7 Lojtarët e skuadrave për fëmijë aktivizohen në veprimtaritë e tyre vetëm kur lista emërore e skuadrës së tyre të jetë firmosur dhe vulosur nga Klubi/Shoqata sportive.

GJYQTARËT

- 12.8 Komisionet e gjyqtarëve apo çdo gjyqtarë/e në mënyrë individuale duhet të ketë dhe të depozitojë në sekretariatit e FSHV-së, 30 ditë parafillimit të çdo sezoni sportiv, formularët model të FSHV-së të kërkuara sipas kësaj rregulloreje:
 - a. Formularin e regjistrimit (federimit) të gjyqtarit/res, kolektive apo individuale të nënshkruar nga çdo gjyqtar/e me të dhënat e kërkuara sipas kësaj rregullore.
 - b. Çertifikatën mjeksore për çdo gjyqtarë/e.
 - c. Siguracionin e jetës për çdo gjyqtarë/e.
 - d. Liçensimin për çdo gjyqtarë/e sipas tarifave të parashikuara në këtë rregullore.
- 12.9 Gjyqtarët duhet të kenë dokumentacionin që përmban rregullorja teknike dhe rregullorja e brendëshme, të gjitha ndryshimet përkatëse të bëra në këto rregullore, si dhe udhëzimet e dërguara me shkrim nga sekretariati i FSHV-së.
 - 12.9.1 Lista e federimit të gjyqtarëve pjesëmarrës në veprimtaritë zyrtare kombëtare ku përfshihen arbitrat e kategorisë së parë, kategorisë së dytë dhe kategorisë së tretë duhet të jetë e miratuar

nga Sekretari i Përgjithshëm i FSHV-sv. Ajo duhet të përmbajë këto të dhëna: Emër dhe mbiemër, datëlindja, vendbanimi (adresa e plotë), profesioni, vendi i punës, arsimi përkatës, gjuhë huaj, kategoria sportive, numri i telefonit dhe adresa e e-mail- it.

- 12.9.2 Lista e federimit të gjyqtarëve do të firmoset nga çdo gjyqtarë/e, zyrtarizohet nga Kryetari i Komisionit Teknik-Arbitral dhe miratohet nga Sekretari i Përgjithshëm i FSHV-së.

KAPITULLI XIII

RREGULLORE E SKUADRAVE KOMBËTARE

NENI 13. Skuadra Kombëtare është ajo që merr pjesë në një garë sportive/aktivitet, e cila është e përfshirë në programin e vendosur nga Komiteti Ekzekutiv. Ajo është e zgjedhur nga Presidenti dhe Komiteti Ekzekutiv. Skuadra kombëtare është e autorizuar të përfaqësojë Shqipërinë në të gjitha veprimtaritë ndërkombëtare zyrtare dhe miqësore. Skuadrat Kombëtare që kanë të drejtë të përfaqësojnë Shqipërinë janë:

- a. Skuadra Kombëtare Femra (Të Rritura)
- b. Skuadra Kombëtare Meshkuj (Të Rritur)
- c. Skuadra Kombëtare Femra (Të Reja), (U-20)
- d. Skuadra Kombëtare Meshkuj (Të Rinjë), (U-21)
- e. Skuadra Kombëtare Femra (Para të Reja), (U-18)
- f. Skuadra Kombëtare Meshkuj (Para të Rinjë), (U-19)
- g. Skuadra Kombëtare Femra (Para para të Reja), (U-16)
- h. Skuadra Kombëtare Meshkuj (Para para të Rinjë), (U-17)
- i. Skuadra Kombëtare e Veteranëve (deri në 50 vjeç)
- j. Skuadrat Kombëtare të Beach-Volley (femra e meshkuj për të gjitha moshat).

13.1 Struktura e skuadrës Kombëtare përbëhet nga:

- a. Struktura e përherëshme;
- b. Struktura e përkohëshme e përgatitjes;
- c. Struktura e përkohëshme e garës/aktiviteti (delegacionit)

13.2 Struktura e përherëshme është e përbërë nga:

- a. Trajneri/e i/e parë;
- b. Trajneri/e i/e dytë;
- c. Team manager/e;

- d. Mjeku/e;
 - e. Fizoterapisti/e;
- 13.3 Struktura e përkohëshme e përgatitjes është e përbërë nga:
- a. Trajneri/e i/e parë;
 - b. Trajneri/e i/e dytë;
 - c. Team manager/e;
 - d. Mjeku/e;
 - e. Fizoterapisti/e;
 - f. Përgatitësi/e atletik/e (nëse nevojitet);
 - g. Statisticioni/e scoutman;
 - h. Përgjegjësi/e lokal (nëse është i përcaktuar);
- 13.4 Struktura e përkohëshme e garës/aktivitetit është e përbërë nga:
- a. Kreu i delegacionit;
 - b. Team manager/e;
 - c. Trajneri/e i/e parë;
 - d. Trajneri/e i/e dytë;
 - e. Lojtarët;
 - f. Mjeku/e;
 - g. Fizoterapisti/e;
 - h. Përgatitësi/e atletik/e (nëse nevojitet);
 - i. Scoutman/e (statisticien nëse nevojitet);
 - j. Videoman/e (nëse nevojitet);
- 13.5 Trajneri/e i/e parë është i propozuar nga Presidenti dhe i zgjedhur nga Komiteti Ekzekutiv dhe ka këto funksione:
- 13.5.1 Trajneri/rja që thirret nga Sekretariati i FSHV-së për të drejtuar skuadrën Kombëtare është i detyruar të paraqitet pranë skuadrës;
- 13.5.2 Ai/ajo përgatit për çdo vit programin e punës së skuadrës duke vënë në dukje të gjitha garat/aktivitetet tek të cilat gjykon që duhet të ketë pjesëmarrje dhe e komunikon këtë pranë Komitetit Ekzekutiv për aprovim;

- 13.5.3 Ai/ajo propozon vendet e stërvitjes në përputhje me kërkesat dhe mundësitë e Federatës;
- 13.5.4 Ai/ajo zbaton programin e aprovuar nga Komiteti Ekzekutiv;
- 13.5.5 Ai/ajo paraqit listën e lojtarëve me interes kombëtar në lidhje me skuadrën e tij;
- 13.5.6 Ai/ajo mban raportet direkte me lojtarët;
- 13.5.7 Ai/ajo përcakton lojtarët të cilët do të jenë pjesë përbërëse e skuadrës në garë/aktivitet, midis tyre që ka përzgjedhur më parë si lojtarë me interes kombëtar, dhe e komunikon këtë listë pranë Komitetit Ekzekutiv.
- 13.5.8 Ai/ajo përcakton kapitenin e ekipit;
- 13.5.9 Kujdeset për mbarëvajtjen e formës psiko-fizike e teknike të lojtarëve si dhe drejtimin e skuadrës në garat/aktivitetet zyrtare dhe miqësore;
- 13.5.10 Sinjalizon tek Team manager-i /ja çdo thyerje disipline nga ana e lojtarëve;
- 13.5.11 Merr pjesë në cermonitë dhe manifestimet zyrtare të organizuara nga KOKSH, FSHV, CEV, FIVB ku është i ftuar.
- 13.5.12 Trajneri/ja i/e parë i skuadrave kombëtare për të rritura e të rritur zgjidhet për një periudhë prej 2 (dy) sezone sportive, kurse për skuadrat kombëtare për të reja, të rinjë, para të reja dhe para të rinjë zgjidhet para çdo aktiviteti ndërkombëtar për të cilin është konfirmuar pjesëmarrja.

- 13.5.13 Presidenti dhe Komiteti Ekzekutiv kanë të drejtën të ndryshojnë trajnerin e parë të skuadrave Kombëtare, në rastet e mëposhtëme:
- Kur trajneri/ja nuk arrin të realizojë asnjë nga objektivat e përcaktuara;
 - Kur trajneri/ja nuk realizon seancat stërvitore në përputhje me programin e planin e caktuar;
 - Kur trajneri/ja nuk ndërton marrdhënie korrekte me lojtarët e skuadres kombëtare;
 - Kur trajneri/ja nuk respekton dhe nuk zbaton udhëzimet e Komitetit Ekzekutiv të FSHV-së;
 - Kur trajneri/ja thyen rregullat e lojës dhe dënohet për mosrespektim të tyre;
 - Kur trajneri/ja nuk dorëzon në rregull bazën materiale ose abuzon me të;
 - Kur trajneri/ja bën sulme e shpifje publike kundër personave zyrtarë të FSHV-së.
- 13.5.14 Trajneri/ja i/e skuadrës Kombëtare është i detyruar që për çdo aktivitet zyrtar ndërkombëtar të nënshkruajë kontratën individuale respektive me Sekretariatën e FSHV-së.
- 13.5.15 Kriteret për zgjedhjen e trajnerit/es të parë të skuadrat Kombëtare për të rritura dhe të rritur janë:
- Të ketë kategorinë e tretë sportive në volejboll të miratuar nga Presidenti dhe Sekretari i Përgjithshëm i FSHV-së ose kategori të fituara në kurset zyrtare të FIVB-së;
 - Të ketë njohuri të përgjithëshme të gjuhës angleze si gjuhë zyrtare e FIVB dhe CEV;
 - Të jetë me moshë nga 30 deri në 65 vjeç (mosha do të llogaritet sipas vitit të lindjes);
 - Të përfaqsojë dhe të mbështesë me dinjitet politikën e objektivat e volejbollit të FSHV-së;
 - Të paraqesë programe stërvitore duke parashikuar objektiva të qarta për përgatitjen fizike, teknike, taktike dhe rezultatin e

ekipit që do të drejtojë, si dhe relacionin me shkrim pas veprimtarisë;

- f. Të njohë rregulloren ndërkombëtare të FIVB, rregulloren e brendëshme të FSHV-së, si dhe të marrë pjesë dhe të ndihmojë FSHV në kurset e kualifikimit për trajnerë/e të organizuara prej saj;
- g. Të jetë korrekt dhe i disiplinuar në zbatimin e rregulloreve zyrtare të volejbollit;
- h. Të ketë qendrim të mirë moral dhe të jetë i padënuar nga rregulloret e FSHV-së;
- i. Të jetë i aftë fizikisht dhe në gjendje të mirë shëndetsore;
- j. Të bashkëpunojë dhe të plotësojë çdo detyrë të ngarkuar nga Komiteti Ekzekutiv dhe sekretariati i FSHV-së.
- k. Trajneri/ja i/e parë i skuadrave Kombëtare për të rritura dhe të rritur mund të zgjidhen dhe trajnerë Shqiptarë të cilët punojnë si trajnerë jashtë vendit, si dhe trajnerë me nënshtetësi të huaj;
- l. Trajnerë të parë mund të zgjidhen edhe ata trajnerë/re të cilët nuk janë antarë të ndonjë klubi apo shoqate sportive që merr pjesë në aktivitetet zyrtare kombëtare të FSHV-së, por që janë ekspertë të suksesshëm në fushën praktike dhe teorike të volejbollit.

13.6 Detyrat e trajnerit /es së dytë:

- a. Trajneri/ja i/e dytë është i zgjedhur nga Komiteti Ekzekutiv me propozimin të trajnerit/res të parë.
- b. Ai mbështet trajnerin/en e parë në përmbushjen e detyrave për mbarëvajtjen e formës së lojtarëve dhe të drejtimit të skuadrës, mbi të gjitha nga pikëpamja teknike.
- c. Përmbush, nese nevojitet, nevojat organizative të lidhura me mirë funksionimin e aktivitetit teknik të përgatitjes së garës/aktivitetit.

13.7 Detyrat e mjekut/es:

- a. Mjeku/ja është i zgjedhur nga Komiteti Ekzekutiv.

- b. Mbështet trajnerin/en e parë në mbarëvajtjen e formës psiko-fizike të lojtarëve nga pikpamja mjekesore dhe bashkëpunon me të në përgatitjen e programit të stërvitjes ditore;
- c. Duhet të jetë i pranishëm ose lehtësisht i arritshëm për të gjithë kohën e përgatitjes dhe garës/aktivitetit të skuadrës;
- d. Duhet të garantojë vazhdimësinë e asistencës së përditëshme të lojtarëve, duke mbajtur përgjegjësi për zëvendësimin e tij të përkohshëm;
- e. Mbikëqyr kujdesjen e gjendjes fizike të lojtarëve, duke mbajtur raporte me informacione reciproke për palët;
- f. Ndihmon të gjithë pjesët përbërëse të strukturës së skuadrës Kombëtare;
- g. Eshhtë përgjegjës në përshkrimin e ilaçeve dhe mjekimeve siç kërkohet nga Rregullorja Antidoping-ut;
- h. Përgatit një skedë sanitare për çdo lojtar/re dhe në fund të sezonit ia dorëzon një kopje të interesuarit (lojtarit/es) si dhe një kopje (pas konsensusit nga lojtari/ja) ja dorëzon Komitetit Ekzekutiv;
- i. Në fund të çdo manifestimi/gare/aktiviteti duhet të përgatisë një relacion për trajnerin, Komitetin Ekzekutiv duke vënë në dukje çështje patalogjike të ndodhura si dhe trajnimet terapeutike të ndërmarra për çdo lojtar/re si dhe skuadrës ku bën pjesë.

13.8 Detyrat e fizioterapisti/es:

- a. Fizioterapisti/ja është i zgjedhur nga Komiteti Ekzekutiv me propozim të mjekut.
- b. Në harmoni me direktivat e mjekut kryen funksionet e veçanta për kualifikimin profesional që ai ka në përputhje me kërkesat e mjekut dhe trajnerit/es;
- c. Kryen çdo ditë funksionet paramjeksore të lidhura me specialitetin e tij profesional.

13.9 Detyrat e team manager-it/es:

- a. Team manager-i/ja është i zgjedhur nga Komiteti Ekzekutiv, me propozim të Sekretarit të Përgjithshëm. Përfaqson zyrtarisht federatën kur nuk është i pranishëm Presidenti ose kreu i delegacionit;
- b. Ka përgjegjësinë organizative dhe administrative të skuadrës Kombëtare në Shqipëri dhe jashtë vendit dhe i delegohen vendimet finale për mirëfunksionimin organizativ të strukturës;
- c. Përgatit në përputhje me problematikën logjistike-administrative e lidhur me zhvillimin e stërvitjeve dhe garave/aktiviteteve të skuadrës Kombëtare në Shqipëri dhe jashtë vendit, në harmoni me vendimet e Komitetit Ekzekutiv, por edhe të Sekretariatit të Përgjithshëm, të Trajnerit/es dhe strukturës mjeko-sanitare;
- d. Mban kontakte direkte midis trajnerëve, lojtarëve, Sekretarit të Përgjithshëm dhe zyrës së shtypit;
- e. Në manifestimet/garat/aktivitetet ndërkombëtare mban kontakte me organizatorët, me delegatin teknik të FIVB-së ose BVA-së dhe me presidentin e jurisë;
- f. Është përgjegjës për vlerat monetare të dhëna nga sekretariati, në cilësinë e funksionarit të deleguar për shpenzimet dhe materialet teknike të nevojshme për skuadrën;
- g. Kujdeset për raportet me autoritetet administrative dhe sportive lokale, kombëtare ose ndërkombëtare në vendin ku zhvillohen gara/aktiviteti; pas apovimit të programit vjetor të punës, i komunikon institucioneve të zonës së interesuar datat, vendin dhe praninë e skuadrës kombëtare në teritorin e tyre;
- h. Mbikëqyr disiplinën tek të gjithë pjesët përbërëse të strukturës së skuadrës Kombëtare, dhe nëse ka shkelje të disiplinës të kryera nga pjesët përbërëse të strukturës dhe që janë të një niveli të lehtë dhe nuk janë subjekt sanksionesh, ndërmerr pa formalitete disa masa të nevojshme si psh. masëme tërheqje vëmendje edhe me shkrim, mosaktivizim i përkohshëm dhe largim nga delegacioni (në rastet kur ekipi ndodhet jashtë vendit, kthim në Shqipëri) duke informuar në

këtë rast menjëherë Komitetin Ekzekutiv për situatën; lojtari/ja ose pjesa përbërëse e strukturës, i cili largohet, nuk mund të marrë pjesë në asnjë aktivitet zyrtar për të gjithë kohën e parashikuar për impenjimin e skuadrës Kombëtare, deri në përfundimin e delegacionit;

- i. Nëse shkelja e disiplinës është e një niveli të lartë, atëherë njofton menjëherë Komitetin Ekzekutiv duke i vënë në dispozicion të gjithë dokumentacionin për çështjen subjekt të cilin do ta gjykoj Komisioni i Disiplinës me masat përkatëse;
- j. Në përfundim të një manifestimi/gare/aktiviteti përgatit një relacion me shkrim për Sekretaritin e Përgjithshëm.

13.10 Detyrat e përgatitësit/es atletik/e:

- a. Përgatitësi/ja atletik/e, është i zgjedhur nga Komiteti Ekzekutiv me propozimin e trajnerit/es të parë.
- b. Ai/ajo mbikëqyr përgatitjen fizike të lojtarëve duke bashkëpunuar ngushtë me stafin teknik.

13.11 Detyrat e Scoutman/ja:

- a. Scoutman/ja është i zgjedhur nga Komiteti Ekzekutiv në bazë të propozimit të trajnerit/es të parë:
- b. Ai/ajo kryen përpunimin në kohë reale, të gjithë të dhënave në lidhje me çdo sportist/e i/e angazhuar në garë/ndeshje dhe bashkepunon ngushtë me trajneret;
- c. Përpunimin e të dhënave të skuadrave të huaja (kundërshtarë);
- d. Në fund të aktivitetit, dorëzon pranë Sekretarit të Përgjithshëm një relacion me shkrim, duke i bashkëngjitur të gjitha të dhënat e përpunuara në mënyrë që të krijohen një bankë të dhënash.

13.12 Detyrat e Videoman/e:

- a. Videoman/e është i zgjedhur nga Komiteti Ekzekutiv në bazë të propozimit të trajnerit të parë.

- b. Ai regjistron dhe përpunon filmimet te skuadrës Kombëtare dhe të skuadrave kundërshtare, duke bërë një relacion stafit teknik;
- c. Në fund të aktivitetit dorëzon pranë Sekretarit të Pergjithshëm një relacion me shkrim, duke i bashkangjitur të gjithë materialet e prodhuara në mënyrë që të krijohen një bankë të dhënash.

13.13 Përgjegjësi/ja lokal/e

Përgjegjësi/sja lokal/e është i/e zgjedhur nga Komiteti Ekzekutiv në bazë të propozimit të autoriteteve Rajonale të interesuara. Ai/ajo kryen të gjithë asistencën tekniko-organizative të nevojshme me qëllimin e realizimit sa më mirë dhe sa më të lehtë qëndrimin dhe aktivitetin e skuadrës kombëtare.

13.14 Kreu i delegacionit

Kreu i Delegacionit është Presidenti ose një delegate i tij që përfaqëson zyrtarisht FSHV-në në brendësi të strukturës së skuadrës Kombëtare.

Kreu i Delegacionit merr detyrat e tij në momentin e krijimit të strukturës së përkohëshme të garës/aktivitetit (delegacionit) dhe e mban këtë detyrë deri në momentin e mbarimit ose shkrirjes së kësaj strukture.

13.15 Lojtarët kombëtarë

Lojtarët kombëtarë duhet të kenë nënshtetësinë Shqiptare. Për interesa të rezultateve, me skuadrat kombëtare mund të seleksionohen edhe lojtarë të “natyralizuar” në përputhje me rregullat dhe standartet e përcaktura nga FIVB dhe CEV. Lojtarët e skuadrave kombëtare do të zgjidhen duke patur parasysh nënshtetësinë, moshën, gjininë, gjendjen shëndetësore, perspektivën dhe testimin e tyre. Ato ndahen në dy grupe:

- a. Lojtarë/e të interesit kombëtar;
- b. Lojtarë/e Kombëtar (shiponja)

- 13.16 Lojtarët e interesit kombëtar
Janë lojtarë/e të intaresit kombëtar ata të cilët Komiteti Ekzekutiv i ka përcaktuar dhe kualifikuar sipas kërkesave të trajnereve dhe rregullores. Lojtari/ja mund të refuzojë kualifikimin vetëm për motive të jashtëzakonshme. Refuzimi duhet të jetë formalisht i pranuar nga Komiteti Ekzekutiv.
- 13.17 Lojtarët kombëtar (shqiponja)
Janë të kualifikuar si “Shqiponja” ata lojtarë të cilët zgjidhen për të formuar skuadrën Kombëtare që do të marrin pjesë në garat/ndeshjet/aktivitetet ndërkombëtare zyrtare midis skuadrave Kombëtare “senior-s”. Lojtarët e skuadrave të tjera kombëtare (rinj, reja, para rinj, para reja, parapara rinj, parapara reja) do të kualifikohen si “kombëtarë”.
- 13.18 Lojtarët kombëtar: Detyrimet
- 13.8.1 Lojtarët e skuadrave kombëtare janë të detyruar të respektojnë në mënyre të plotë programet e stervitjeve dhe të ndeshjeve të aprovuara nga Komiteti Ekzekutiv.
- 13.8.2 Lojtarët e skuadrave kombëtare mund të marrin pjesë në të gjitha ndeshjet e ekipeve të tyre (ku luajnë në kampionat) vetëm nëse nuk duhet të marrin pjesë në të njëjtën kohë në ndeshjet/garat/aktivitetet e skuadres kombëtare.
- 13.8.3 Lojtarët e skuadres kombëtare që thirren nga Sekretariati i FSHV-së për të qenë pjesë e skuadrës kombëtare janë të detyruar të paraqiten pranë skuadrave kombëtare respektive;
- 13.8.4 Lojtarët të cilët janë caktuar për të qenë pranë skuadrës kombëtare, largohen nga skuadra kombëtare për motive personale të pajustificuara, përjashtohen për një periudhë prej 2 (dy) vitesh nga skuadra kombëtare, si dhe nuk lejohen të

aktivizohen me asnjë skuadër si brenda vendit ashtu dhe jashtë vendit.

- 13.8.5 Lojtarët e skuadrave kombëtare meshkuj e femra të të gjitha moshave janë të detyruar te dorëzojnë në përfundim të aktiviteteve sportive gjithë bazën materiale në magazinën e FSHV-së, në të kundert ato nuk do të lejohen të regjistrohen (liçensohen) në asnjë ekip apo shoqatë sportive.
- 13.8.6 Përbëjnë thyerje të disiplinës të cilat mund të penalizohen me ndërprerje nga çdo aktivitet kombëtar:
- a. Mosparaqitja e lojtarit/es në vendin dhe orën e takimit të skuadrës si dhe mungesa e pjesmarrjes, e cila nuk është e justifikuar, në programin e përgaditjes individuale ose kolektive të skuadrës kombëtare ose të garave/ndeshjeve;
 - b. Komunikimi me vonesë i pamundësisë për të marrë pjesë në aktivitetet e përmendura më lart;
 - c. Mungesa në impenjimin e detyruar të kryerjes së aktiviteteve të përgaditjes ose të ndeshjeve/garave, si dhe refuzimi i kryerjes së direktivave të dhëna nga trajneri ose Team Manager-i;
 - d. Kur ka kryer akte ose ka lëshuar deklaratat, për më tepër në publik, të cilat shkelin të drejtën e kritikës dhe korrektesisë dhe mund të përkeqësojnë harmininë e skuadrës kombëtare dhe ndikojë negativisht mbi rezultatin e garës/ndeshjes;
 - e. Kur veshin gjatë impenjimeve të stervitjeve dhe të garave/ndeshjeve material të ndryshme nga veshja zyrtare e skuadrave kombëtare (siç parashikohet me sponsorin teknik të FSHV-së).
 - f. Thyerjet e disiplinës të cilat të bazuar ne Rregulloren e Disiplines si dhe ato te Kodit te Etikes janë të një niveli më të rëndë se ato të përmendura me lart, do të komunikohen në mënyrë të menjëherëshme tek Team Manager dhe Komisioni i Disiplines për hapjen e një procedimi disiplinor.

13.19 Kapitani/ja

Kapiteni/ja i/e skuadrës kombëtare i percaktuar nga trajneri/e i parë, duhet të ketë disa të dhëna të veçanta morale, një numër të madh pjesmarrjeje në skuadrën kombëtare dhe një rendiment ekselent dhe konstant. Funkcionet e kapitenit, mbi ato të parashikuara nga rregulloret ndërkombetare, janë ato të përfaqësimit të skuadrës kombëtare në ceremonitë zyrtare të organizuara nga FSHV, CEV, FIVB, BVA, si dhe shembulli i asistencës morale kundrejt të gjithë lojtarëve të tjerë të skuadrës. Kapiteni/ja mund të jetë zëri i atleteve të tjere në lidhje me kërkesat e tyre në adresë të trajnerëve dhe Team Manager-it. Eshhtë përgjegjës i sjelljes së skuadrës gjatë ceremonive dhe rreshtimit të skuadrës në fushë në fillim dhe fund të ndeshjes. Nërreshtimin dhe parakalimin, ai është në krye të skuadrës.

13.20 Mbajtesi/ja i/e flamurit

Lojtari/ja më i ri/e në moshë i skuadrës do të ketë detyrën e mbajtësit të flamurit të Republikës së Shqipërisë në të gjitha parakalimet dhe ceremonitë zyrtare.

13.21 Uniforma

Uniformat e lojtarëve “Shqiponja” dhe kombëtarë janë të përcaktuara nga FSHV. Çdo lojtari/e i dorëzohet një uniformë e përfaqësimit, një uniformë loje, një uniformë stervitjeje dhe materialet e nevojshme që e plotësojnë uniformën.

13.21.1 Lojtarët nuk mund të përdorin uniforma ose materiale të ndryshme nga ato të dhëna nga FSHV; gjithashtu nuk mund të shtojnë tek uniformat e dhëna (shkrime, stampime, stema, logo të ndryshme nga ato të parashikuara në modelet e dhëna nga FSHV).

13.21.2 Lojtarët janë përgjegjës për ruajtjen dhe përdorimin me kujdes të uniformave dhe materialeve të tjera; mund të kenë zëvendësim të tyre vetëm në rastet kur ato janë prishur nga përdorimi i tepërtose janë të papërdorëshme.

- 13.21.3 Ndërrimi i pjesëve të uniformës me skuadrat e tjera kombëtare është i lejuar vetëm për bluzët dhe vetëm nëse është dhënë më parë autorizimi nga Team-Manager-i.
- 13.21.4 Në rastet kur dorëzimi i uniformave është me mungesë të ndonjë pjese të saj, atëherë ajo do të ngarkohet lojtarit/es ose stafit të skuadrës të cilit i është dhënë në dorëzim, me mundësinë epagimit të kostos të sejcilës në mënyrë që të rikuperohen shpenzimet e kryera për to, por gjithmonë nëse Komiteti Ekzekutiv nuk ka vendosur ndryshe.
- 13.21.5 Uniforma e përfaqësimit nuk mund të vishet në raste të ndryshme nga manifestimet / garat / ndeshjet zyrtare ndërkombëtare.
- 13.22 Thirrja e Ekipeve Kombetare: rregullat e përgjithshme
Në fillim të çdo sezoni sportiv, pas aprovimit të programit nga Komiteti Ekzekutiv, FSHV komunikon programin në përgjithësi të impenjimeve të përgaditjeve të të gjithë skuadrave kombëtare, si dhe të kurseve të përgaditjeve dhe të angazhimit të lojtareve me interes kombëtar, në veçanti për kohëzgjatjen e tyre, vendin dhe kohën e zhvillimit.
Thirrjet për impenjimet e veçanta, si të përgaditjeve dhe garave, duhet të jenë të dërguara tek skuadrat e lojtarëve ku ata bëjnë pjesë në kampionatet e tyre. Sekretariati i FSHV njofton zyrtarisht klubet e shoqatat sportive për vendimin mbi caktimin trajnereve dhe lojtarëve të skuadrave kombëtare të cilat janë pjesë e atij/asaj klubi apo shoqate sportive.
- 13.23 Lojtarët: Të drejtat
Lojtarët e skuadrave Kombetare kanë të drejtën:
a. E trajtimit të diferencuar gjatë periudhës së përgaditjes si dhe në pjesëmarrjen në çdo aktivitet / gara / ndeshje të kërkuara nga sektori i skuadrave kombëtare pranë FSHV-së;

- b. E një kuote të përditëshme, nëse parashikohet nga Komiteti Ekzekutiv dhe në masën e përcaktuar nga ai;
- c. Lojtarëve të skuadrave kombëtare mund ti jepen gjithashtu edhe çmime speciale ose shpërblime për rezultatet e arritura, bazuar në vendimet e Komitetit Ekzekutiv të FSHV.
- d. Të gjithë atletet “Shqiponja” janë të regjistruar në një Libër Nderi, i cili ruhet në Sekretarinë e Përgjithëshme, dhe kanë të drejtën të kenë një dinstiktiv të dhuruar nga FSHV.
- e. “Shqiponja-t”, mbi të gjitha, kanë të drejten e hyrjes së lirë në të gjitha manifestimet/ ndeshjet/garat e volejbollit të njohura dhe organizuara nga FSHV në Shqipëri. Për këtë qëllim, do të pajisen me një kartë të veçantë për t’u identifikuar. FSHV njofton KOKSH për lojtarët “Shqiponja” të cilët janë të shquar në fushën sportive.

KAPITULLI XIV

RREGULLI UNIK I FSHV

NENI 14. Presidenti dhe Komiteti Ekzekutiv i FSHV-së kanë të drejtën në çdo kohë, të miratojnë zyrtarisht vendime për ndryshime të nevojshme, për nene të veçanta të kësaj rregullore ose vendime për ndryshime të veçanta, të cilat nuk janë parashikuar në këtë rregullore.

- 14.1 Në përputhje me nenin 14, Presidenti dhe Komiteti Ekzekutiv kanë të drejtë të marrin vendime të karakterit organizativ, administrative, teknik dhe disiplinor, për çdo klub, shoqatë, lojtar/e, trajner/e, zyrtar apo gjyqtar, me qëllimin e zbatimit të rregulloreve të Volejbollit, Kodit të Etikës dhe Disiplinës, si dhe me qëllimin e përmirësimit të cilësisë së organizimit të veprimtarive të volejbollit dhe forcimit të mardhënieve miqësore ndërmjet Klubeve e Shoqatave Sportive në Republikën e Shqipërisë.
- 14.2 Të gjitha vendimet në përputhje me nenet e mësipërme, 14 dhe 14.1 do t'i bashkangjiten Rregullores së Brendëshme dhe janë në fuqi deri në përfundim të çdo sezoni sportiv.
- 14.3 Të gjitha mosmarveshjet ndërmjet Klubeve, Shoqatave dhe Individëve ndërmjet tyre do të shqyrtohen në sekretariatën e FSHV-së, vetëm në rastet kur ato paraqiten zyrtarisht nga Klubi dhe Shoqata, në përputhje me nenet e kësaj rregullore.
- 14.4 Të gjitha Klubet dhe Shoqatat sportive janë të detyruara të bëjnë kontrata të noterizuara ose akt-marveshje, të cilat duhet të nënshkruhen nga secili/la në zyrat e FSHV me lojtarët e tyre, në çdo fillim të ri sezoni sportiv. Kontratot ose akt-marveshjet për

moshat nga 14 -18 vjeç (do të nënshkruhen nga prindi ose kujdestari me ligj) dhe 18-30 vjeç (nënshkruhen nga vetë lojtari/ja).

- 14.5 Të gjitha mosmarveshjet ndërmjet klubeve dhe shoqatave në lidhje me transferimin (lëvizjen) e lojtarëve brenda vendit apo jashtë shtetit, do të merren parasysh për t'u analizuar nga Sekretariati i FSHV, vetëm atëherë kur klubi apo shoqata sportive ka kontratë të noterizuar me lojtarin/en dhe të depozituar në sekretariatit e FSHV-së.
- 14.6 Të gjitha mosmarveshjet ndërmjet klubeve, shoqatave dhe individëve ndërmjet tyre me FSHV-në, do të zgjidhen në Komisionin e Arbitrazhit Sportiv (KAS) pranë KOKSH.

MIRATUAR NGA KOMITETI EKZEKUTIV I FSHV-së Maj, 2023

Presidenti

Erlind PELLUMBI

Sekretari i Përgjithshëm

Ervis DOSTI

Shënim: Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë. Rregullorja e mëparëshme shfuqizohet.